



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# Metodika e Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare

VERSIONI 3.0







BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# **Metodika e Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare**

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
DEPARTAMENTI PËR STATISTIKA

MAJ 2015



**PUBLIKUES**

© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës  
Garibaldi 33, Prishtinë 10000

Tel: ++381 38 222 055

Fax: ++381 38 243 763

**Ueb-faqe:**

[www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)

**E-mail:**

[statistics@bqk-kos.org](mailto:statistics@bqk-kos.org)

## PËRMBAJTJA

1.	HYRJE.....	7
2.	STATISTIKAT E BILANCIT TË PAGESAVE DHE POZICIONIT TË INVESTIMEVE NDËRKOMBËTARE.....	8
2.1.	KORNIZA LEGJISLATIVE .....	8
2.2.	ORGANIZIMI I BRENDSHËM .....	8
2.2.1.	DIAGRAMI ORGANIZATIV I BQK-SË.....	9
2.3.	BASHKËPUNIMI I JASHTËM .....	10
2.4.	PËRDORUESIT.....	10
3.	SISTEMI STATISTIKOR.....	11
4.	KONCEPTET, PËRKUFIZIMET DHE PRAKTIKAT E DAKORDUARA.....	16
4.1.	PARIMET E PËRGJITHSHME TË STATISTIKAVE TË BILANCIT TË PAGESAVE DHE POZICIONIT TË INVESTIMEVE NDËRKOMBËTARE .....	16
4.2.	MALLRAT.....	27
4.3.	SHËRBIMET.....	28
4.6.	TË ARDHURAT PARËSORE.....	34
4.4.1	KOMPENSIMI I PUNONJËSVE.....	34
4.4.2	TË ARDHURAT NGA INVESTIMET.....	34
4.4.2.1	TË ARDHURAT NGA INVESTIMEVE DIREKTE.....	35
4.4.2.2	TË ARDHURAT NGA INVESTIMET E PORTOFOLIT.....	35
4.4.2.3	TË ARDHURA NGA INVESTIME TJERA.....	35
4.4.3	TË ARDHURAT NGA ASETET REZERVË.....	35
4.5.	TË ARDHURAT DYTËSORE.....	36
4.6.	LLOGARIA KAPITALE.....	37
4.6.1.	PËRVETËSIMI DHE ASGJËSIMI I MJETEVE JO PRODHUESE-JOFINANCIARE.....	37
4.6.2.	TRANSFERET KAPITALE .....	37
4.7.	LLOGARIA FINANCIARE.....	38
4.7.1.	INVESTIMET DIREKTE.....	38
4.7.1.1.	PËRKUFIZIMI I IHD-VE.....	38
4.7.1.2.	METODAT VLERËSUESE.....	39
4.7.2.	INVESTIMET PORTFOLIO.....	39
4.7.2.1.	PËRKUFIZIMI .....	39
4.7.3.	INVESTIME TJERA.....	39
4.7.3.1.	PËRKUFIZIMI .....	40
4.7.3.2.	METODAT VLERËSUESE.....	40
4.7.4.	ASETET REZERVË.....	40
4.7.4.1.	PËRKUFIZIMI .....	40

**4.7.5. GABIMET DHE HARRESAT NETO..... 41**



## 1. HYRJE

Ky dokument ka për qëllim të u ofrojë përdoruesve një përmbledhje të veçorive kryesore të kornizës metodologjike për Bilancin e Pagesave (BP) të Kosovës dhe Pozicionin e Investimeve Ndërkombëtare (PIN). Konceptet dhe përkufizimet janë në përputhje me edicionin e gjashtë të *Manualit të Bilancit të Pagesave dhe Investimeve Ndërkombëtare (BPM6)* të publikuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) në vitin 2009 dhe Sistemin e Llogarive Kombëtare 2008 (2008 SNA). Ky dokument përmban shpjegime të përgjithshme për çdo komponent të BP dhe PIN që do t'i ndihmojnë përdoruesit e statistikave të sektorit të jashtëm (SSJ) në leximin e statistikave.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) është përgjegjëse për hartimin dhe shpërndarjen e BP, PIN dhe statistikave të ndërlidhura të sektorit të jashtëm, siç është borxhi i jashtëm, statistikave të investimeve të huaja direkte dhe statistikave për asetet e rezervuara për Kosovën. Këto statistika paraqesin raportet ekonomike të Kosovës lidhur me pjesën tjetër të botës dhe janë tregues të rëndësishëm të performancës ekonomike.

Pasqyra e parë gjithëpërfshirëse vjetore e BP të Kosovës është publikuar në vitin 2006 me të dhënat për periudhën referuese 2004-2005. Që nga viti 2009 janë publikuar statistika tremujore të BP. Nga viti 2015, BQK-ja ka filluar publikimin e të dhënave për BP në baza mujore. Të dhënat për PIN dhe statistikave të borxhit të jashtëm (SBJ) janë publikuar për herë të parë në vitin 2011, me periodicitet vjetor që fillon nga viti 2007. Tani, statistikave për PIN dhe SBJ publikohen në baza tremujore, me afat kohor prej t + 90 ditë.

Përgatitja e statistikave të BP nënkupton mbledhjen e të dhënave nga: agjencitë qeveritare, sektori financiar (BQK-ja, bankat komerciale, kompanitë e sigurimit, fondet pensionale, institucionet mikrofinanciare, etj.), raportet e drejtpërdrejta nga kompanitë e mëdha jo-financiare, organizatat ndërkombëtare në Kosovë, ambasadat dhe burimet tjera.

Ky dokument lëshohet nën përgjegjësinë e Divizionit për Bilancin e Pagesave në BQK dhe publikohet në ueb-faqen e BQK-së ([www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)).

BQK - Metodika e Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare

## 2. STATISTIKAT E BILANCIT TË PAGESAVE DHE POZICIONIT TË INVESTIMEVE NDËRKOMBËTARE

### 2.1. Korniza legjislative

Përgjegjësia e BQK për hartimin e BP rrjedh nga neni 25 i Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Sipas nenit 25, BQK-ja ka këto përgjegjësi për të përmbushur objektivat e saj:

- mbledhë, përpilojë, analizojë, përmbledhë dhe publikojë statistika dhe informacione të nevojshme për realizimin e detyrave të veta;
- Bordi i bankës Qendrore do të përkufizojë, me anë të rregulloreve, informacionin statistikor të kërkuar si dhe formën në të cilën ky informacion do t'i sigurohet Bankës Qendrore, personat fizikë dhe juridikë që iu nënshtrohen kërkesave të raportimit, regjimin e aplikuar të konfidencialitetit si dhe ndëshkimet administrative, në përputhje me nenin 67, paragrafi

2 të këtij ligji, që mund t'u shqiptohen personave fizikë dhe juridikë që veprojnë në shkelje të këtyre kërkesave statistikore;

- bashkëpunojë me ministritë dhe agjencitë qeveritare në mbledhjen, përpilimin dhe publikimin e statistikave dhe informacioneve të tjera relevante;
- koordinojë me agjenci bilaterale dhe multilaterale adaptimin e standardeve ndërkombëtare të shpërndarjes së të dhënave me qëllim të arritjes së konsistencës dhe efikasitetit në organizimin e statistikave dhe informacionit.

Ligji për BQK mund të gjendet në ueb-faqen zyrtare të BQK-së<sup>1</sup>. [Me qëllim të specifikimit të qartë të përgjegjësisë, si dhe autoritetit të BQK-së për mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e statistikave të sektorit të jashtëm, BQK-ja ka nxjerrë Rregulloren për Bilancin e Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare](#)<sup>2</sup>. Për më tepër, sipas “Ligjit për Statistika Zyrtare të Republikës së Kosovës”, BQK-ja është një nga prodhuesit kryesorë të statistikave zyrtare në Republikën e Kosovës<sup>3</sup>. Statistikat nën përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të BQK-së janë statistikat monetare dhe financiare dhe statistikat e sektorit të jashtëm.

## 2.2. ORGANIZIMI I BRENDSHËM

BQK-ja menaxhohet nga Bordi i Bankës Qendrore, i cili përbëhet nga Guvernatori dhe katër anëtarë jo ekzekutiv, të cilët janë përgjegjës për miratimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave dhe mbikëqyrjen e administratës dhe aktiviteteve të BQK-së.

BQK-ja është e ndarë në departamente dhe divizione. Divizioni për Bilancin e Pagesave operon në kuadër të Departamentit të Statistikave dhe aktualisht përbëhet nga 7 punonjës, duke përfshirë Udhëheqësin e Divizionit, i cili është përgjegjës për përpilimin, metodologjinë dhe shpërndarjen e BP, PIN, statistikave të borxhit të jashtëm dhe statistikave tjera të ndërlidhura të sektorëve të jashtëm për Kosovën.

<sup>1</sup> Për qasje në Ligjin për BQK-në, ju lutemi vizitoni linkun: <http://www.bqk-kos.org/repository/docs/2010/Ligji%20per%20BQK-ne.pdf>.

<sup>2</sup> Për qasje në Rregulloren për BP dhe PIN, ju lutemi vizitoni linkun: [www.bqk-kos.org/repository/docs/korniza\\_ligjore/shqip/Statistika%20e%20BP%20dhe%20PIN.pdf](http://www.bqk-kos.org/repository/docs/korniza_ligjore/shqip/Statistika%20e%20BP%20dhe%20PIN.pdf)

<sup>3</sup> Për qasje në Ligjin për Statistika Zyrtare, ju lutemi vizitoni linkun: <http://ask.rks-gov.net/media/1857/lae-on-official-statistics-of-republic-of-kosovo.pdf>



## 2.3. BASHKËPUNIMI I JASHTËM

Partnerët kryesorë të jashtëm të Departamentit të Statistikave janë:

- Korporatat financiare;
- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) – shkëmbimi i të dhënave të nevojshme për BP
- Doganat e Kosovës – ofrues i Statistikave të Tregtisë së Jashtme (STJ);
- Ministritë (e punëve të jashtme, financave, agjencitë qeveritare);
- Policia e Kosovës – ofron statistika për hyrjen dhe daljen e personave në kufi;

BQK mban kontakt të rregullt me institucionet fqinje, si Bankën e Shqipërisë dhe Bankën Qendrore e Malit të Zi. Shqipëria dhe Mali i Zi janë destinacionet më të popullarizuara për pushime për Kosovarët gjatë verës dhe ne shkëmbejmë të dhëna për vlerësimin e të dhënave për debi të udhëtimeve. BQK-ja gjithashtu mban kontakte me shumë kompani dhe organizata të mëdha që i japin BQK-së të dhëna statistikore në baza ad hoc.

## 2.4. PËRDORUESIT

Të dhënat për BP, PIN, borxhin e jashtëm dhe investimet e huaja direkte janë postuar në ueb-faqen e BQK-së, në dispozicion për të gjithë përdoruesit.

Për më tepër, të dhënat dhe publikimet procedohen në parlament, qeveri, Agjencinë e Statistikave të Kosovës (me qëllim të hartimit të BPV), institucionet private dhe publike kërkimore, universitetet, agjencitë vlerësuese, etj.

Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe Analizave Ekonomike është një përdorues i rëndësishëm i të dhënave tona brenda BQK-së.

Statistikat për BP, PIN, borxhin e jashtëm dhe investimet direkte raportohen tek Eurostat, FMN dhe Banka Botërore në baza të rregullta.

## 3. SISTEMI STATISTIKOR

### 3.1. LLOJI I SISTEMIT TË MBLEDHJES

Përpilimi i statistikave për BP, PIN dhe borxhin e jashtëm bazohet në një sistem të përzier, i cili përdorë një kombinim të anketave dhe të dhënave të shlyerjes.

Një nga burimet më të rëndësishme të informacioneve për mbledhjen e të dhënave të statistikave të jashtme janë transaksionet e regjistruara nga bankat komerciale (SRTN). Sistemi i shlyerjes ofron të dhëna për përpilimin e BP, me ndarje të detajuara të instrumentit/kategorisë dhe sektorit. Në SRTN raportohen të gjitha transaksionet kreditore dhe debitorë, kodi i vendit, emri i transaktorit (rezident dhe jo-rezident), data e transaksionit, përshkrimi dhe kodi identifikues i bankës. Të dhënat përgatiten dhe raportohen në baza mujore. Deri në vitin 2010, pragu ishte mbi 10,000 Euro, i cili ishte eliminuar pas vitit 2010, që kur të gjitha transaksionet ndërkombëtare duhet të raportohen. Gjithashtu, që nga viti 2010, një kornizë shtesë i është shtuar raporteve të SRTN. Në këtë shtesë raportohen transaksionet e bëra me kartela debitorë/kreditore nga jo-rezidentët në Kosovë dhe transaksionet e kartelave debitorë/kreditore nga Kosovarët jashtë vendit.

Burimet tjera për përpilimin e statistikave të BP janë: anketat, statistikat për tregti të jashtme dhe raportet nga institucionet qeveritare. Këto të dhëna plotësohen më tej me informacionet e pranuar nga burimet tjera (EULEX-i dhe Donatorët), vlerësimet e Divizionit të BP – Departamenti i Statistikave dhe anketat tremujore të BP. Për identifikimin e kompanive kryesore të huaja në Kosovë, ne përdorim informacionet nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, SRTN dhe informacionet tjera nga institucionet qeveritare.

Divizioni për Statistika Monetare dhe Financiare është një burim i rëndësishëm i brendshëm i të dhënave. Ai i ofron Divizionit për Statistika të BP të dhëna lidhur me bankat dhe institucionet tjera financiare.

### 3.2. AGJENTËT RAPORTUES

Statistikat për BP dhe PIN përpilohen në bazë të raporteve të ofruara kryesisht nga agjentët në vijim:

**BQK:** *Divizioni për Statistika Monetare dhe Financiare* ofron të dhëna lidhur me të dhënat e Bilancit Sektorial të Gjendjes, Asetet Zyrtare të Rezervuara dhe transaksionet tjera dhe gjendja e asetëve që i përkasin aktiviteteve të BQK-së. Përveç kësaj, ky divizion ofron të dhëna lidhur me aktivitetet e institucioneve të huaja kreditore.

**Sektori bankar:** bankat duhet të raportojnë të gjitha transaksionet e jashtme të ndërmarra për llogari të tyre në baza të përgjithshme sipas llojit të transaksionit, valutës dhe vendit të homologut jo-rezident. Ato gjithashtu duhet të mbledhin nga klientët e tyre formularë për raportim statistikor lidhur me transaksionet e jashtme dhe të dërgojnë informacione për BP në mënyrë elektronike në BQK duke përdorur një rrjet të veçantë që lidh bankën qendrore dhe bankat raportuese.

Sektori qeveritar: ministri të ndryshme dhe departamente qeveritare ofrojnë informata lidhur me transaksionet e tyre. Më e rëndësishmja nga këto është Ministria e Financave, Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Doganat e Kosovës.

Sektorët tjerë: për disa zëra të BP dhe PIN shumica e të dhënave mblidhen drejtpërdrejt nga kompanitë, p.sh. për investime të huaja direkte, komponentët e shërbimeve, etj. Lloji i formularëve të anketave që dërgohen tek kompanitë varet nga aktiviteti që ato kryejnë. Aktualisht janë duke u përdorur disa formularë të ndryshëm. Emrat e këtyre formave të raportimit janë paraqitur në tabelën 1.

**Tabela 1. Anketat e ndërmarrjeve - Skema raportuese për mbledhjen e të dhënave për BP dhe PIN në Kosovë**

Popullsia e synuar për anketim (p.sh. banka komerciale, etj.)	Emri i formularit për raportim	Përmbajtjet e formularit raportues	Shpeshtësia e raportimit	Afati kohor (numri i ditëve për dorëzim pas përfundimit të periudhës referuese)
Bankat Komerciale	Formulari: TB	Të gjitha transaksionet bankare me jo-rezidentët.	Mujore	t + 15 ditë kalendarike
Bankat Komerciale	Formulari: TK	Të gjitha transaksionet e klientëve të bankës me jo-rezidentët. Ekzistojnë formularë të veçantë për transaksionet mbi 10 mijë Euro (TK ≥ 10000) dhe ato nën 10 mijë Euro (TK < 10000).	Mujore	t + 15 ditë kalendarike
Bankat Komerciale	Formulari: TKK	Transaksionet e Klientëve të Bankës me kartela kreditore/debitore	Mujore	t + 15 ditë kalendarike
Bankat Komerciale	Formulari: PI	Portofolio e investimeve në ekuitet dhe letrat me vlerë të borxhit të emetuara nga jo-rezidentët dhe të mbajtura nga bankat komerciale.	Mujore	t + 15 ditë kalendarike
Ndërmarrjet Investuese Direkte	Formulari: Informacionet e përgjithshme	Informacionet e përgjithshme, si emri i kompanisë, aktiviteti, numri i punonjësve, etj.	Tremujore	t + 30 ditë kalendarike
Ndërmarrjet Investuese Direkte	Formulari: Ekuiteti	Gjithsej ekuiteti (periudha e fillimit, transaksioni, ndryshimet tjera, fundi i periudhës, interesi, etj.)	Tremujore	t + 30 ditë kalendarike
Ndërmarrjet Investuese Direkte	Formulari: Detyrimet	Detyrimet janë kredi, depozita, kredi tregtare, instrumente të tregut të parasë, derivativët financiar që kompania ka tek investuesit direkt, investuesit e tjerë dhe jo-rezidentët tjerë.	Tremujore	t + 30 ditë kalendarike
Ndërmarrjet Investuese Direkte	Formulari: Investimet jashtë vendit	Mjetet si kredi, depozita, kredi tregtare, instrumente të tregut të parasë, derivativë financiar që kompania ka investuar jashtë vendit.	Tremujore	t + 30 ditë kalendarike
Ndërmarrjet Investuese Direkte	Formulari: Shërbimet	Shërbimet e klasifikuara sipas standardeve të përcaktuara në BPM6.	Tremujore	t + 30 ditë kalendarike

Ndërmarrjet Investuese Direkte	Formulari: Arkëtimet tjera dhe pagesat në vendet tjera	Eksporti dhe importi i mallrave, donacioneve, granteve dhe formave tjera të arkëtimeve dhe pagesave.	Tremujore	t + 30 ditë kalendarike
Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës	Formulari: PIA	Investimi në ekuitet.	Tremujore	t + 30 ditë kalendarike
Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës	Formulari: PIA	Investimet në letrat me vlerë të borxhit – investimet në obligacionet e thesarit dhe shënimet dhe investimet në instrumentet e tregut të parasë.	Tremujore	t + 30 ditë kalendarike

### 3.3. PRAGJET e SRTN

Sistemi për Raportimin e Transaksioneve Ndërkombëtare (SRTN) është burimi kryesor për përpilimin e bilancit të pagesave dhe PIN. Nga viti 2004 deri në vitin 2010, bankat komerciale kanë raportuar vetëm transaksionet në vlerë mbi 10,000 Euro. Këto transaksione përmbajnë informatat e të detajuara të nevojshme për përpilimin e BP. Nën këtë vlerë, transaksionet janë raportuar por vetëm në total, në mënyrë të ndarë për debi dhe kredi dhe numrin e transaksioneve.

Pragu është larguar në vitin 2010. Pasi që bankat komerciale kanë të dhëna në sistemet e tyre financiare, do të raportohen të gjitha transaksionet nga 0 deri në 10,000 Euro. BQK punon nga afër me zyrtarët e bankave komerciale për sigurimin e cilësisë së të dhënave. Pjesa tjetër e raportit duhet të kontrollohet mirë nga bankat komerciale para se të dërgohet tek BQK-ja.

### 3.4. DISPONUESHMËRIA E TË DHËNAVE

Duke filluar nga viti 2015, të dhënat për BP përpilohen në baza mujore dhe shpërndahen jo më vonë se gjashtë ditë pas përfundimit të muajit referues. PIN dhe SBJ përpilohen dhe shpërndahen në baza tremujore, me vonesë prej 90 ditëve pas përfundimit të tremujorit referues. Të dhënat tremujore në Eurostat shpërndahen në vonesë kohore prej 83 ditëve pas përfundimit të tremujorit referues.

Të dhënat për BP kanë qenë në dispozicion nga viti 2004, të cilat janë përpiluar dhe publikuar në baza vjetore deri në vitin 2008. BP tremujore është në dispozicion me ndarje të detajuar të instrumentit/kategorisë dhe sektorit nga viti 2009. PIN dhe statistikat e borxhit të jashtëm janë përpiluar nga viti 2012 në baza tremujore. Të dhënat vjetore janë në dispozicion për periudhën 2007-2011.

Të dhënat e publikuara sipas publikimeve paraprake kalendarike dhe udhëzimeve “Sistemit të Përmirësuar të Shpërndarjes së të Dhënave të Përgjithshme” (e-GDDS) të FMN jo më vonë se tre muaj pas përfundimit të periudhës referuese (<http://www.bqk-kos.org/?cid=1.152>). Të dhënat publikohen nga bazë të strukturës standarde (duke përfshirë instrumentet), siç rekomandohet në *BPM6*.

### 3.5. AFATI KOHOR

Përgatitja e të dhënave të BP dhe PIN rezulton nga disa faza, si: grumbullimi, përpilimi, validimi dhe publikimi. Tabela në vijim tregon afatet kohore për secilën fazë:

**Tabela 2: Afati kohor për përpilimin e statistikave të sektorit të jashtëm**

Përshkrimi	Grumbullimi	Përpilimi	Validimi	Publikimi
Llogaria rrjedhëse – Mujore	t+30	t+45	t+55	t+60
Llogaria e kapitalit – Mujore	t+30	t+45	t+55	t+60
Llogaria financiare – Mujore	t+30	t+45	t+55	t+60
Statistikat e PIN dhe Borxhit të Jashtëm - Tremujore	t+60	t+75	t+80	t+90

### 3.6. SHPESHTËSIA E PËRPILIMIT

BP i Kosovës përpilohet në baza mujore. PIN dhe borxhi i jashtëm përpilohen në baza tremujore. Përpilimi dhe publikimi i statistikave bëhet sipas standardit ndërkombëtar të pranuar më së fundi, si edicioni i gjashtë i *Manualit të Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare (BPM6)*.

### 3.7. ZBATIMI I MANUALIT BPM6

Që nga muaji shtator i vitit 2014, BQK-ja ka filluar përpilimin dhe publikimin e statistikave të BP dhe PIN sipas *BPM6*. Tranzicioni në edicionin e ri është bërë në harmoni me kërkesat e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe udhëzimet e Bashkimit Evropian. Të gjitha statistikave të sektorit të jashtëm përpilohen sipas standardeve ndërkombëtare.

BQK ofroi zbatimin e plotë të *BPM6* me të dhëna nga viti 2004. Gjithashtu, të gjitha statistikave për borxhin e jashtëm në dispozicion janë konvertuar sipas metodologjisë së re.

BQK gjithashtu ka përgatitur dhe publikuar të gjitha dokumentet e ndërlidhura me tranzicionin në *BPM6*, si metodika e bilancit të pagesave dhe PIN, matrica për tranzicionin në edicionin e ri (*BPM6*), dokumenti "pyetjet më të shpeshta", fjalorthi për BP dhe PIN.

### 3.8. KONTROLLET E TË DHËNAVE

Të dhënat kontrollohen brenda mjedisit "mainframe" për qëllime të validimit, si dhe në nivel teknik, për të verifikuar përmbajtjen e tyre (përshtatshmërinë, plotësinë, etj.) dhe kohezionin. Oputputet e ndërmjetme të të dhënave dhe statistikave vlerësohen dhe validohen rregullisht. Procedurat e kontrollit kanë për qëllim rritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së të dhënave. Kontrollat sistematike të cilësisë përfshijnë: largimin e gabimeve në përpunimin e të dhënave, mos-përputhshmëritë, etj. Anketat, SRTN dhe burimet tjera të informatave ofrojnë informacione shtesë nga të cilat mund të dalin nga verifikimet, verifikimet e përputhshmërisë dhe analiza e detajuar nga e cila dalin pasaktësitë dhe mos-përputhshmëritë e mundshme në raportet fillestare.

Verifikimi i cilësisë së të dhënave në nivelin më të ulët fillon me verifikimet për çdo raport individual (anketat, SRTN), si dhe verifikimi nëse të dhënat nga anketat dhe transaksionet SRTN përputhen me

njëra tjetrën. Raportet mbi rrjedhat nga SRTN krahasohen edhe me pozicionin e jashtëm të agjentit raportues, siç raportohet nga anketat. Çdo mospërputhje e konsiderueshme ndërmjet rrjedhave dhe stoqeve në nivel të kompanisë hetohet drejtpërdrejtë me kompaninë individuale. Ndërmarrjet e mëdha monitorohen nga afër. Përveç kësaj, hetohen edhe mospërputhjet statistikore dhe treguesit tjerë potencial të problemeve në outputet statistikore. Vëmendje e veçantë i kushtohet monitorimit të gabimeve dhe lëshimeve.

### 3.9. POLITIKA E RISHIKIMIT

Edhe pse nuk ka politikë të publikuar të rishikimeve, BQK-ja realizon përditësime të rregullta të të dhënave kur vihen në dispozicion. Bëhen shqyrtime të rregullta dhe të parregullta të të dhënave.

Shqyrtimi i rregullt: shqyrtimet paraprake tremujore (apo mujore) publikohen së bashku me të dhënat në tremujorin (apo muajin) e ardhshëm. Të dhënat e shqyrtuara vjetore për vitin referues publikohen së bashku me të dhënat për tremujorin e parë të vitit të ardhshëm. Më shpesh, shqyrtimi për tërë vitin bëhet për komponentët e investimeve direkte. Gjithashtu, për llogaritë e mallrave të dhënat shqyrtohen për vitin e kaluar në tremujorin e parë të vitit vijues (kur të dhënat për vitin përkatës vihen në dispozicion, p.sh. në fund të muajit mars). Në rast të ndryshimeve të mëdha metodike apo mospërputhjet ndërmjet burimeve të të dhënave, do të shqyrtohen të dhënat për tri vitet e kaluara (t-3).

Shqyrtimet e parregullta: kur është e përshtatshme, shqyrtimet afatgjata do të merren parasysh, si kur metodika është ndryshuar nga *BPM5* në *BPM6*.

### 3.10. PUBLIKIMI DHE SHPËRNDARJA

Të dhënat publikohen në përputhje me kornizën e kërkesave të GDDS të FMN. Të dhënat lëshohen në të njëjtën kohë tek të gjitha palët e interesuara duke i postuar ato në ueb-faqen zyrtare të BQK-së.

Të gjitha statistikat e BP publikohen rregullisht në ueb-faqen e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në seri kohore (<http://bqk-kos.org/?id=55>). Gjithashtu, statistikat janë në dispozicion për publikime të ndryshme: Buletini Mujo Statistikor (<http://bqk-kos.org/?id=97>), Raporti Mujo (<http://bqkkos.org/index.php?m=t&id=102>) dhe Raporti i Zhvillimeve Makroekonomike (<http://bqkkos.org/index.php?id=101>).

Gjithashtu, BQK-ja përgatitë komunikatë për shtyp para publikimit të statistikave në ueb-faqe në seritë kohore. Kjo komunikatë përmban informacione të përgjithshme lidhur me statistikat që publikohen dhe ka për qëllim informimin e publikut.

### 3.11. KONTRIBUTI NË STATISTIKAT TJERA

Statistikat e Sektorit të Jashtëm përpilohen nga BQK-ja për të kontribuar drejtpërdrejtë në përpilimin e statistikave të llogarive kombëtare për Kosovën të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Ato gjithashtu përdoren nga sektori publik dhe privat për analizë dhe llogaritje të treguesve të ndryshëm makroekonomik.

## 4. KONCEPTET, PËRKUFIZIMET DHE PRAKTIKAT E DAKORDUARA

### 4.1. PARIMET E PËRGJITHSHME TË STATISTIKAVE TË BILANCIT TË PAGESAVE DHE POZICIONIT TË INVESTIMEVE NDËRKOMBËTARE

Siç u shpjegua më lartë, statistikat për BP dhe PIN të Kosovës ndjekin klasifikimet e *BPM6*.

#### 4.1.1. Bilanci i Pagesave

Bilanci i Pagesave (BP) është pasqyrë statistikore e transaksioneve ekonomike ndërmjet rezidentëve dhe jo-rezidentëve në një ekonomi gjatë një periudhe specifike kohore. Transaksioni është ndërveprim ndërmjet dy njësive institucionale që ndodh me marrëveshje të ndërsjellë apo nëpërmjet operimit të ligjit dhe përfshinë shkëmbimin e vlerës ekonomike apo transferin e saj.

Në fakt, transaksionet ndërkombëtare të regjistruara në BP mund të përfshijnë transferimin e parave dhe disa prej tyre nuk paguhen si: ndërrimi i pronësisë është koncept relevant për regjistrimin e transaksioneve. Ky zhvillim nga qasja financiare drejt qasjes ekonomike është konsideruar më i përshtatshëm në mënyrë që të: (i) nxisë një interpretim të qëndrueshëm ekonomik të shifrave; dhe (ii) sigurojë përputhjen e koncepteve të BP me llogaritë kombëtare (BP korrespondon me llogarinë “pjesa tjetër e botës”).

BP organizohet në dy llogari kryesore:

- llogaria rrjedhëse dhe kapitale;
- llogaria financiare.

Llogaria rrjedhëse tregon rrjedhën e mallrave, shërbimeve dhe të ardhurave ndërmjet rezidentëve dhe jo-rezidentëve. Llogaria e kapitalit tregon rrjedhën e aseteve jo-prodhuese, jo-financiare dhe transferet e kapitalit ndërmjet rezidentëve dhe jo-rezidentëve. Llogaria financiare tregon blerjet neto dhe posedimin e aseteve financiare dhe detyrimeve të grupuara në pesë kategoritë funksionale në vijim:

- investim direkt;
- investim të portofolios;
- derivativët financiar;
- investime tjera;
- asete rezervë.

Llogaritë rrjedhëse dhe kapitale regjistrojnë rrjedha bruto; rrjedhat hyrëse klasifikohen si kredi, ndërsa rrjedhat dalëse klasifikohen si debi. Për dallim, llogaritë financiare regjistrojnë transaksione neto në mënyrë të ndarë për çdo aset dhe detyrim financiar (d.m.th. paraqesin ndryshimet që dalin nga të gjitha hyrjet të kreditit dhe debitit gjatë periudhës së kontabilitetit). Blerja neto e aseteve

financiare regjistron të gjitha blerjet minus asetet në posedim, ndërsa paraqitja neto e detyrimeve regjistron të gjitha paraqitjet minus riblerja e detyrimeve.

Shuma e bilanceve të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale korrespondon me kreditimin (suficitin) neto apo huamarrjen (deficitin) neto të ekonomisë lidhur me pjesën tjetër të botës. I njëjti koncept mund të del nga llogaria financiare si blerja neto e aseteve financiare minus paraqitja neto e detyrimeve.

#### 4.1.2. Pozicioni i Investimeve Ndërkombëtare

Pozicioni i Investimeve Ndërkombëtare (PIN) është pasqyrë statistikore që tregon, në një periudhë specifike kohore, vlerën e stoqeve të aseteve financiare të rezidentëve që janë kërkesa jo-kontigjente në jo-rezidentët në atë ekonomi apo një shufër ari e mbajtur si aset rezervë dhe detyrimeve jo-kontigjente të rezidentëve për jo-rezidentët në atë ekonomi. Sikurse për llogarinë financiare të BP, asetet dhe detyrimet financiare grupohen në pesë kategori funksionale.

Përveç aseteve/detyrimeve financiare “normale”, kjo përfshinë edhe tokën, pronat e tjera të patundshme (p.sh. vendbanimet) dhe asetet tjera paluajtshme.

Statistikat e PIN të Kosovës përpilohen dhe publikohen në baza tremujore. Metodika për përpilim bazohet në rekomandimet e BPM6. PIN përpilohet për të gjitha zërat e llogarive financiare (investimi direkt, investimi i portofolios, investimet tjera dhe asetet rezervë). Burimet e të dhënave për përpilimin e PIN janë kryesisht të njëjta me ato të BP. Për disa zëra specifik përdoren burime të ndryshme të të dhënave. Për shumicën e zërave, PIN dhe BP barazohet.

Asetet dhe detyrimet përpilohen ndarazi. Dallimi ndërmjet aseteve dhe detyrimeve financiare paraqet PIN neto. Paraqet dëmin neto apo detyrimin neto për jo-rezidentët.

Ndryshimet në PIN ndërmjet periudhave të njëpasnjëshme mund të ndodhin për shkak të transaksioneve, siç regjistrohet në llogarinë financiare të BP gjatë asaj periudhe, apo rrjedhat tjera (shih më poshtë).

Koncepti i borxhit të jashtëm bruto ndërlidhet me PIN, dhe paraqet shumën e papaguar të detyrimeve aktuale në vend se atyre kontigjente që kërkojnë pagesë/pagesa të principalit dhe/ose interesit nga debitori në një pikë/pika në të ardhmen dhe që i detyrohen jo-rezidentëve nga rezidentët e një ekonomie. Koncepti i borxhit të jashtëm neto mund të nxirret edhe duke zbritur asetet e jashtme bruto në instrumentet e borxhit nga koncepti i borxhit të jashtëm bruto. Në praktikë, koncepti i “borxhit” korrespondon me letrat me vlerë të borxhit, valutat, depozitat, kreditë dhe kreditë tregtare.

#### 4.1.3. Përputhshmëria e pozicioneve dhe rrjedhave

Ndryshimet në pozicione ndërmjet periudhave të njëpasnjëshme shpjegohen nga rrjedhat në vijim gjatë asaj periudhe:

- (1) Transaksionet në llogarinë financiare të BP;
- (2) Ri-vlerësimet (ndryshimet në normën e këmbimit të Euros kundrejt valutave në të cilat denominohen asetet/detyrimet dhe/ose në çmimin e aseteve/detyrimeve);

(3) Ndryshimet e tjera në vëllimin e aseteve dhe detyrimeve (si ri-klasifikimet dhe shlyerjet).

Sa më të detajuara të jenë informatat bazike lidhur me stoqet dhe rrjedhat – përkatësisht ndarja e valutës, çmimet e aplikueshme të tregut (veçanërisht për investimet e portofolios) dhe afati kohor i transaksionit (duke përdorur çmimin dhe normën e këmbimit për atë datë) – aq më saktë do të përputhen pozicionet e njëpasnjëshme.

Rivlerësimet janë mbajtja e fitimeve apo humbjeve në pozicionet ndërkombëtare që dalin nga ndryshimet në normën e këmbimit (në rastin e aseteve dhe detyrimeve të lëshuara në valutë të huaj) dhe/ose çmimet tjera, se sa nga transaksionet.

Për aksionet e ekuitetit të kompanive jo të listuara, transaksionet e regjistruara në llogarinë financiare të BP mund të ndryshojnë nga dallimi në fondet vetanake në vlerën e librit (OFBV) të regjistruar në PIN. Dallimet e tilla regjistrohen si rivlerësime për shkak të ndryshimeve në çmim.

Për instrumentet e pa-negociueshme, përkatësisht kreditë, depozitat dhe llogaritë tjera të arkëtueshme/pagueshme, transaksionet e llogarive financiare, të cilat vlerësohen në çmimet e tregut, do të dallojnë për nga ndryshimi në vlerat nominale të regjistruara në PIN. Dallimet e tilla regjistrohen si ndryshime të tjera në çmim gjatë periudhës kur realizohet transaksioni.

Ndryshimet e tjera në volumin e aseteve dhe detyrimeve regjistrohen në rastet kur asetet e reja që nuk kanë qenë në bilancin e gjendjes në fillimit të periudhës shfaqen në bilancin e gjendjes të fundit të periudhës, apo kur asetet ekzistuese që kanë qenë në bilancin e gjendjes në fillimin e periudhës zhduken nga bilanci i gjendjes në fund të periudhës dhe këto shfaqje/zhdukje nuk janë rezultat i transaksioneve. Këto përfshijnë shlyerjet e dëmeve nga kreditorët, ri-klasifikimet statistikore (të instrumenteve, sektorëve, etj.) dhe monetizimi dhe demonetizimi i shufrës së arit.

Kur shlyhen instrumentet financiare që vlerësohen në vlera nominale, atëherë vlera e regjistruar në ndryshimet tjera në vëllim duhet të korrespondoj me vlerën e tyre nominale para shlyerjes. Për ri-klasifikime (p.sh. ri-klasifikim sektorial), vlerat e instrumenteve të reja dhe të vjetra në përgjithësi janë identike.

#### **4.1.4. Parimet kryesore të kontabilitetit për transaksionet dhe pozicionet**

##### **4.1.4.1. Sistemi për regjistrim të dyfishtë**

Në pasqyrën e BP, çdo transaksion regjistrohet me dy hyrje me vlerë të njëjtë. Një nga këto hyrje është përcaktuar si kredi ndërsa tjetra është përcaktuar si debit. Në parim, shumat e të gjitha hyrjeve kreditore është identike me shumën e të gjitha hyrjeve debitore dhe bilanci neto i të gjitha hyrjeve në pasqyrë është zero. Megjithatë, në praktikë llogaritë shpesh nuk janë të barabarta. Afati kohor dhe efektet e vlerësimit së bashku me një shumëllojshmëri të faktorëve tjerë kanë tendencë të shkaktojnë pabarazi në informacionet e regjistruara.

##### **4.1.4.2. Koha për regjistrimin e transaksioneve**

Të gjitha zërat e BP dhe PIN regjistrohen në baza akruale, që do të thotë se transaksionet regjistrohen kur vlerat ekonomike krijohen, transformohen, shkëmbehen, transferohen apo shlyhen. Pretendimet dhe detyrimet dalin kur ka ndërrim të pronësisë. Ndryshimi mund të jetë ligjor apo ekonomik. Në

praktikë, kur ndërrimi i pronësisë nuk është i dukshëm, ndërrimi mund të vlerësohet në kohën kur palët në transaksion e regjistrojnë atë në librat apo llogaritë e tyre.

#### 4.1.4.3. Vlerësimi i transaksioneve dhe stoqeve

Çmimet e tregut janë baza për vlerësim në llogaritë ndërkombëtare.

Çmimi i tregut për një transaksion është shuma e parave që blerësit janë të interesuar të paguajnë për të blerë diçka nga shitësit e interesuar. Nëse këto çmime nuk mund të respektohen, vlerësimi sipas çmimeve ekuivalente të tregut – çmimet e tregut për artikuj të njëjtë apo të ngjashëm, të marra nga tregjet në të cilat artikuj të njëjtë apo të ngjashëm tregtohen aktualisht në numra të mjaftueshëm dhe rrethana të ngjashme – ofron një përafrim të pranueshëm të çmimeve të tregut.

Importet dhe eksportet e mallrave të përgjithshme regjistrohen në vlera FOB (të lira në bord – “free on board”).

Transaksionet e aseteve dhe detyrimeve financiare duhet të regjistrohen ekskluzivisht për komisione, tarifa dhe taksa. Këto duhet të regjistrohen ndarazi nën kategori të duhura.

Në përgjithësi, pozicionet në asete dhe detyrime financiare duhet të vlerësohen si të jenë blerë në treg në datën e raportimit të bilancit të gjendjes. Shumë asete financiare tregtohen në tregje në baza të rregullta dhe prandaj mund të vlerësohen drejtpërdrejt duke përdorur kuotimet/çmimet e kuotuarra nga këto tregje. Nëse tregjet financiare janë të mbyllura në datën e bilancit të gjendjes, atëherë duhet të përdoren çmimet e tregut në datën më të afërt vijuese.

Vlerësimi sipas ekuivalentit të vlerës së tregut është i nevojshëm për asetet dhe detyrimet financiare që nuk tregtohen në tregjet financiare apo tregtohen shumë rrallë. Vlerat e drejta që përafrojnë çmimet e tregut duhet të vlerësohen për këto asete dhe detyrime. Vlera aktuale e rrjedhave të ardhshme të parave është një nga përafrimet valide.

Pozicionet në kredi, depozita dhe kredi tregtare dhe avance dhe llogaritë tjera të arkëtueshme/pagueshme regjistrohen në vlerë nominale.

#### 4.1.4.4. Parimi i ndarjes gjeografike për ndërrimin e pronësisë

Ndarja e detajuar gjeografike është në dispozicion për komponentin e madh të BP dhe PIN. Tregtia me mallra, tregtia me shërbime, remitencat, investimet direkte, letrat me vlerë, etj., janë në dispozicion sipas ndarjeve të ndryshme gjeografike. Të dhënat janë në dispozicion nga viti 2009, të regjistruara në një bazë të detajuar të të dhënave me shumë informacione tjera në dispozicion. Pothuajse të gjithë zërat e mëdhenj të BP mund të përpilohen nga vendet.

Për të pasur një ndarje më të saktë gjeografike sipas perspektivës së analizës së rrezikut, *BPM6* kërkon aplikimin e parimit debitor/kreditor. Sipas këtij parimi, transaksionet/pozicionet në asetet financiare të një vendi i caktohen vendit në të cilën lind detyrimi (debitori) dhe transaksionet/pozitat e detyrimeve financiare të një vendi i caktohen vendit të rezidencës së kreditorit.

Për dallim, aplikimi i parimit të transaktorit përkthehet në klasifikimin e transaksioneve/pozicioneve sipas të cilave vendi i homologut jo-rezident të njohur së pari apo sipas vendbanimit, ku të dyja mund

të mos pasqyrojnë vendin e rezidencës të pronarit real të aseteve/detyrimeve të marra/që rezultojnë në të gjitha rastet.

#### 4.1.4.5. Grumbullimi dhe rrjetëzimi

Grumbullimet apo kombinimet në të cilat të gjitha zërat elementar paraqiten me vlerën e tyre të plotë quhen regjistrime bruto (p.sh. të gjitha kreditë e interesit grumbullohen ndarazi nga gjitha debitet e interesit). Llogaritë ndërkombëtare paraqesin regjistrimin bruto në llogaritë e tyre rrjedhëse dhe të kapitalit.

Llogaritë ndërkombëtare paraqesin regjistrimin neto në llogarinë e tyre financiare dhe ndryshimet e tyre përkatëse, që do të thotë se grumbullimet apo kombinimet që paraqesin ndryshime neto (rritjet minus zvogëlimet) në një aset apo detyrim të veçantë financiar. Në përgjithësi, regjistrimi neto i rrjedhave në asetet dhe detyrimet financiare rekomandohet në llogaritë ndërkombëtare nga perspektiva analitike dhe pragmatike. Blerja neto e dëmeve financiare të jashtme dhe paraqitja neto e detyrimeve të jashtme janë në përgjithësi me shumë interes analitik se sa rrjedha bruto. Raportimi bruto i të dhënave mund të mos jetë i mundshëm për klasa të ndryshme të njësive dhe për disa instrumente financiare. Për më tepër, transaksionet në disa asete dhe detyrime financiare shpesh duhet të merren nga dhënat e bilancit të gjendjes sepse transaksionet bruto nuk janë në dispozicion.

#### 4.1.4.6. Imputimet

Përderisa shumica e transaksioneve mund të vrojtohen qartë, disa transaksione nuk i pasqyrojnë marrëdhëniet themelore ekonomike dhe duhet të ri-aranzhohen në mënyrë që llogaritë të paraqesin realitetin ekonomik.

Në imputimin e transaksioneve, regjistrimet krijohen në llogaritë ku nuk identifikohen transaksione të veçanta nga palët e përfshira. Si rregull e përgjithshme, transaksionet imputohen vetëm në raste specifike për të reflektuar raportet themelore ekonomike.

Rastet në vijim janë rastet më të dukshme të imputimit të transaksioneve në llogaritë ndërkombëtare.

(1) Fitimet e ruajtura të ndërmarrjeve të ndryshme të investimeve direkte i atribuohen investitorëve direkt sikur fitimet e mbetura të jenë shpërndarë në proporcion tek aksionet e investitorëve direkt në fitimet e ndërmarrjeve investuese direkte dhe pastaj të ri-investohen nga ata në ndërmarrjen investuese direkte. Arsyeja për këtë trajtim është që pasi që ndërmarrja investuese direkte, sipas përkufizimit, është subjekt i kontrollit apo ndikimit nga një investitor apo investitor direkt, vendimi për mbajtjen e disa nga fitimeve brenda ndërmarrjes paraqet një vendim për investime në pjesën e investitorit apo investitorëve direkt.

(2) Të ardhurat nga investimi të fituara në rezervat teknike të mbajtura nga korporatat e sigurimit konsiderohen të jenë të pagueshme për bartësit e policës, të cilët pastaj duhet të kthejnë fondet tek korporatat e sigurimit si suplemente primi edhe pse në aspektin e rrjedhave aktuale të parave të gatshme të ardhurat pronësore mbahen nga korporatat e sigurimit. I njëjti trajtim vlen për të ardhurat e fituara nëpërmjet investimit të rezervave teknike për garancitë e standardizuara. Të ardhurat nga investimi të fituara në rezervat teknike të mbajtura nga korporatat e sigurimit jetë dhe skemat e përcaktuara të pensioneve të kontributeve, si dhe rritja në të drejta gjatë periudhës për skemat e përcaktuara të pensionit të përfitimeve, gjithashtu

konsiderohen të jenë të pagueshme tek bartësit e policës, të cilët pastaj konsiderohen të marrin pretendimet financiare në korporatat e sigurimit jetë dhe fondet pensionale.

(3) Fitimet e mbetura të fondeve të investimeve trajtohen si të jenë shpërndara tek aksionarët, të cilët pastaj konsiderohen për ri-investim në fond.

#### 4.1.5. Rezidenca

Banorët e Kosovës konsiderohen si subjekte juridike të regjistruar dhe që veprojnë në Kosovë, njësoj konsiderohen edhe individët që jetojnë në Kosovë dhe nuk largohen nga vendi për një periudhë më të gjatë se një vit (me përjashtim të diplomatëve, personelit ushtarak, studentëve dhe pacientëve). Për shkak të specifikave, rëndësi e veçantë i është dhënë trajtimit të UNMIK dhe EULEX, KFOR, dhe stafit tjetër ndërkombëtar në Kosovë.

Në përgjithësi, termi rezident nënkupton që qendra mbizotëruese e interesit ekonomik të një personi është brenda territorit ekonomik të një vendi.

Qendra e interesit ekonomik ekziston kur një njësi angazhohet dhe synon të vazhdojë angazhimin, qoftë pafundësisht ose për një periudhë të caktuar por të gjatë, në aktivitete ekonomike dhe transaksione të një shkalle të konsiderueshme brenda ose nga një lokacion, vendbanim, vendi të prodhimit ose mjedise të tjera brenda një territori. Për arsye praktike, vendndodhja aktuale ose e synuar për një vit ose më shumë përdoret si prag operacional. Megjithatë, shembujt në vijim janë shembuj të rasteve të përcaktimit të vendbanimit.

- Studentët që shkojnë jashtë vendit për studimet të rregullta përgjithësisht vazhdojnë të jenë banorë në territorin në të cilin kanë banuar para se të studiojnë jashtë vendit. Ky trajtim aplikohet pavarësisht se kursi i tyre i studimit mund të kalojë periudhën prej një viti, duke supozuar se lëvizja është e përkohshme dhe kështu qendra e tyre me interes ekonomik mbizotërues mbetet vendi i origjinës.
- Pacientët që shkojnë jashtë vendit për trajtim mjekësor e ruajnë qendrën mbizotëruese të interesit të tyre në territorin në të cilin kanë banuar para se të kenë marr trajtimin, edhe nëse trajtimi zgjat një vit ose më shumë.
- Personeli i anijeve, aeroplanëve, naftë nxjerrësve, stacioneve të hapësirës ose pajisjeve të tjera të ngjashme që veprojnë jashtë një territori ose përtej disa territoreve trajtohen si rezidentë në vendin e tyre të origjinës.
- Diplomatët kombëtarë, paqeruajtësit dhe personeli tjetër ushtarak dhe nëpunësit e tjerë civil të punësuar jashtë vendit në enklavat qeveritare si dhe anëtarët e familjeve të tyre konsiderohen si banorë të territorit ekonomik të qeverisë e cila i ka punësuar.
- Stafi i organizatave ndërkombëtare, përfshirë ata me status diplomatik dhe personelin ushtarak, janë banor në territorin e vendbanimit të tyre kryesor.
- Punëtorët kufitarë, punëtorët sezonalë dhe punëtorët e tjerë me punësim afatshkurtër që kalojnë kufijtë për një periudhë të shkurtër për të kryer një punë konsiderohen rezidentë në territorin ekonomik në të cilin ata mbajnë vendbanimin e përdorur nga pjesëtarët e familjes si vendbanim të tyre kryesor.

Gjatë kryerjes së transaksioneve ndërkombëtare të tokës dhe/ose të ndërtesave (p.sh. shtëpitë për pushim), pronarët e pronave trajtohen sikur të kenë transferuar pronësinë e tyre në një njësi institucionale imagjinare që banon në vendin ku ndodhet prona. Njësia imagjinare trajtohet sikur të jetë në pronësi dhe kontrollohet nga pronari jo-rezident.

Subjekti juridik është rezident në territorin ekonomik sipas ligjeve të të cilit entiteti është inkuorporuar ose regjistruar. Kjo vlen edhe për subjektet juridike me pak ose aspak prani fizike, p.sh. fondet investuese (ndryshe nga menaxherët e tyre), mjetet e sekuritizimit (securitisation) dhe disa subjekte me qëllim të veçantë (SPE). Nëse entiteti nuk është inkuorporuar, ai konsiderohet të jetë rezident i vendit ku sistemi ligjor i cili rregullon krijimin dhe vazhdimin e ekzistencës së njësisë ekonomike.

Filialet janë njësi të ndara institucionale me status të pavarur ligjor, qoftë me pronësi të plotë ose me pjesën më të madhe të pronësisë të mbajtur nga një subjekt tjetër (institucioni amë). Degët janë subjekte pa status të pavarur ligjor (ato janë në pronësi të plotë nga institucioni amë). Sidoqoftë, kur degët janë të vendosura në një vend tjetër nga ai në të cilin është vendosur kompania që i kontrollojnë ato, ato konsiderohen si njësi të veçanta institucionale.

#### 4.1.6. Rezidenca e UNMIK-ut dhe EULEX-it në Kosovë

Trajtimi statistikor i organizatës ndërkombëtare përcaktohet nga standardet ndërkombëtare. Megjithatë, në rastin e Kosovës, bazuar në funksionet që kryejnë UNMIK dhe EULEX në Kosovë, këto dy institucione është vështirë të klasifikohen në kuptimin e plotë të fjalës si organizata ndërkombëtare. Prandaj, vëmendje e posaçme i është kushtuar trajtimit statistikor të këtyre organizatave ndërkombëtare.

Bazuar në kriteret e rezidencës (BPM6, paragrafi 4103 dhe 4104), UNMIK/EULEX janë organizata ndërkombëtare dhe për këtë arsye plotësojnë kushtet për t'u klasifikuar si jo-rezident të Kosovës

Është bërë një dallim i rëndësishëm në trajtimin e UNMIK/EULEX-it si institucion dhe personelit të tyre:

- UNMIK dhe EULEX si institucione janë trajtuar si jorezident të Kosovës;
- Rezidenca e stafit ndërkombëtar të UNMIK dhe EULEX përcaktohet në bazë të kohëzgjatjes së qëndrimit të tyre në Kosovë:
  - Stafi ndërkombëtar i UNMIK/EULEX me kontratë mbi njëvjeçare trajtohen si rezidentë të Kosovës (më tej i referuar si: “stafi ndërkombëtar rezident”);
  - Stafi ndërkombëtar i UNMIK/EULEX me kontratë më të shkurtër se një vit trajtohen si jo-rezidentë të Kosovës (më tej i quajtur 'stafi ndërkombëtar jo-rezident').

Metodologjia për llogaritjen e kostos së UNMIK/EULEX është bazuar në publikimet e UNMIK-ut "Ndikimi i UNMIK në Ekonominë e Kosovës" publikuar në korrik të vitit 2006. Të dhënat mbi UNMIK/EULEX janë përditësuar në bazë të informatave të dhëna drejtpërdrejt nga UNMIK/EULEX dhe publikimet e Kombeve të Bashkuara dhe Komisionit Evropian.

Trajtimi statistikor i këtyre institucioneve bazohet në supozimet e mëposhtme:

- Shpenzimet e UNMIK dhe EULEX (si institucione) për blerjen e mallrave dhe shërbimeve në Kosovë konsiderohen si eksporte (eksportet e shërbimeve qeveritare).
- Shpenzimet e UNMIK dhe EULEX për pagat e personelit (vendor dhe ndërkombëtar) konsiderohen si asistencë teknike (grante) për Qeverinë e Kosovës (transfere rrjedhëse) nga organizatat ndërkombëtare.
  - Stafi rezident ndërkombëtar (me kontratë “më të gjatë se një vit”) i UNMIK/EULEX vlerësohet se shpenzojnë rreth 14% të pagave të tyre në Kosovë, 76% të tjera dërgohet në vendet e tyre (remitanca) kurse 10% shpenzohet për të udhëtuar jashtë vendi (shërbime udhëtimi/debi);
  - Stafi jo-rezident ndërkombëtar i UNMIK/EULEX (me kontratë më pak se një vjeçare), vlerësohet se shpenzojnë rreth 14% të pagës së tyre në Kosovë (shërbime udhëtimi/kredi).

Pagat për stafin rezident ndërkombëtar janë regjistruar nën debi të zërit ‘shërbimet tjera biznesore’.

Në tabelën më poshtë është paraqitur një shembull që ilustron supozimet e mësipërme dhe ndikimin e UNMIK-ut dhe EULEX-it në BP të Kosovës:

Duke supozuar që buxheti i UNMIK/EULEX është 100, korniza e shpenzimeve do të ishte si më poshtë:

Pagat e stafit ndërkombëtar	63
Stafi ndërkombëtar rezident	60
Stafi ndërkombëtar jo-rezident	3
Pagat e stafit lokal	17
Mallrat e importuara	8
Mallrat e blera në Kosovë	2
Shërbimet e importuara	6
Shërbimet e blera në Kosovë	4
<b>Totali i buxhetit të UNMIK-ut/EULEX-it</b>	<b>100</b>

Prandaj, duke zbatuar parimin themelor të regjistrimit kontabël të dyfishtë, në BP do të kemi shënimet e mëposhtme:

**Tabela 1. Shembull hipotetik i UNMIK-ut/EULEX-it në BP**

Llogaria rrjedhëse	Kredi	Debi
Shërbimet e udhëtimit		
Shp. në Kosovë të stafit ndërkombëtar jorezident (14%*3)	0.4	

Shp. e stafit ndërkombëtar rezident për të udhëtuar jashtë (10%*60)		6.0
Shërbimet e tjera biznesore		
Pagat e stafit ndërkombëtar jorezident		3.0
Shërbimet qeveritare		
Shpenzimet për mallra dhe shërbime lokale (2+4)	6.0	
Transferet rrjedhëse		
Totali i pagave (63+17)		80.0
Dërgesat e emigrantëve (76%*60)		45.6
<b>Ndikimi në llogarinë rrjedhëse</b>	<b>86.4</b>	<b>54.6</b>

Si rezultat i supozimeve të paraqitura më lartë, transaksionet e UNMIK-ut/EULEX-it për mallra dhe shërbime të importuara (përveç për transaksionet e bëra në Kosovë) konsiderohen si transaksione ndërmjet jo-rezidentëve, prandaj nuk janë të regjistruara në BP.

#### 4.1.7. Trajtimi i KFOR-it në SSJ

KFOR-i është forcë paqeruajtëse ndërkombëtare që udhëhiqet nga NATO-ja dhe që është përgjegjës për krijimin e një mjedisi të sigurt në Kosovë. KFOR ka hyrë në Kosovë më 12 qershor 1999 me mandat të Kombeve të Bashkuara. KFOR-i është kontingjent ushtarak dhe si i tillë BP në Kosovë trajtohen si jo-rezident.

Në bilancin e pagesave, të dhënat e marra nga KFOR-i të regjistruar në anën kreditore, si pagat, shërbimet dhe mallrat.

#### 4.1.8. Trajtimi i stafit tjetër ndërkombëtar

Sipas standardeve ndërkombëtare, stafi ndërkombëtar në Kosovë (përveç stafit të UNMIK dhe EULEX) i angazhuar në ofrimin e ndihmës teknike apo aktiviteteve tjera në të mirë të institucioneve të Kosovës, trajtohet në bazë të kohëzgjatjes së qëndrimit të tyre. Prandaj, stafi që qëndron më shumë se një vit konsiderohet të ketë qendrën e interesit ekonomik në Kosovë, prandaj trajtohet si rezidentë Kosovarë. Sidoqoftë, stafi ndërkombëtar i ambasadave dhe zyrave tjera të organizatave tjera në Kosovë (diplomatët, personeli ushtarak, dhe punëtorët tjerë të organizatave të tilla si dhe anëtarët e familjeve të tyre, të cilët banojnë në Kosovë dhe gëzojnë imunitetin dhe privilegjet diplomatike) trajtohen si jo-rezidentë të Kosovës.

#### 4.1.9. Alokimi në sektorët institucional

Ndarjet sektoriale të BP dhe PIN në Kosovë janë në përputhje me ndarjen në sektorë të dhënë në *BPM6* dhe paraqiten si në vijim:

- (1) Bankat qendrore;

- (2) Korporatat që pranojnë depozita, përveç bankës qendrore;
- (3) Qeveria e përgjithshme;
- (4) Sektorët tjerë.

Ndarja e plotë e sektorit të BPM6 do të zbatohet gradualisht, me ndarjen e sektorëve tjerë në korporata financiare tjera përveç IMF-së dhe korporatat jo-financiare, ekonomitë familjare dhe institucionet jo-fitimprurëse që iu shërbejnë ekonomive familjare.

### ***Banka Qendrore***

Banka Qendrore është institucioni (apo institucionet) financiare që ushtrojnë kontroll mbi aspektet kyçe të sistemit financiar. Ajo kryen aktivitete të tilla si lëshimi i valutës, menaxhimi i rezervave ndërkombëtare, transaksionet me FMN dhe ofrimi i kredive tek korporatat që pranojnë depozita.

### ***Korporatat që pranojnë depozita, përveç bankës qendrore, përfshijnë:***

Korporatat që pranojnë depozita, përveç bankës qendrore, kanë ndërmjetësimin financiar si aktivitetin e tyre kryesor. Për këtë qëllim, ato kanë detyrime në formë të depozitave apo instrumenteve financiare (siç janë certifikatat afatshkurta të depozitave) që janë zëvendësime për depozita. Në përgjithësi, në këtë nën-sektor klasifikohen këta ndërmjetësues financiar:

- (a) bankat komerciale, bankat “universale” dhe bankat “për të gjitha qëllimet”;
- (b) bankat e kursimeve (bankat e kursimeve të administratorit të besuar dhe asociacionet e kursimeve dhe kredive);
- (c) gjiro-institucionet të postës, post bankat, dhe gjiro bankat;
- (d) bankat e kreditimit rural dhe bankat e kreditimit bujqësorë;
- (e) bankat e kreditimit të kooperativave dhe unionet kreditore;
- (f) Kompanitë e çeqeve të udhëtarëve që kryesisht angazhohen në aktivitete financiare; dhe
- (g) bankat e specializuara apo institucionet tjera financiare nëse marrin depozita apo lëshojnë zëvendësime të afërta për depozita

### ***Qeveria e përgjithshme***

Sektori i qeverisë së përgjithshme përbëhet nga nën-sektorët në vijim:

- Qeveria qendrore (me përjashtim të fondeve të sigurimit social): të gjithë departamentet administrative të shtetit dhe agjencitë e tjera qendrore kompetenca e të cilëve shtrihet në tërë territorin ekonomik (me përjashtim të administratës së fondeve të sigurimit social – shih më poshtë);
- Qeveria shtetërore (me përjashtim të fondeve të sigurimit social): njësitë institucionale që ushtrojnë disa nga funksionet e qeverisë në një nivel më poshtë se ai i qeverisë qendrore dhe mbi nivelin e qeverisë lokale (me përjashtim të administratës së fondeve të sigurimit social – shih më poshtë);
- Qeveria lokale (me përjashtim të fondeve të sigurimit social): ato lloje të departamenteve administrative, agjencive, etj., të shteteve anëtare kompetenca e të cilëve mbulon vetëm një pjesë të kufizuar të territorit ekonomik të një vendi (me përjashtim të agjencive lokale për fonde të sigurimit social – shih më poshtë);
- Fondet e sigurimit social: njësitë institucionale qendrore, shtetërore dhe lokale me aktivitet kryesor ofrimin e përfitimeve sociale dhe të cilat përmbushin këtë kriter: me ligj apo me rregullore grupe të caktuara të popullsisë obligohen të marrin pjesë në skemë apo të paguajnë kontribute;
- Qeveria e përgjithshme është përgjegjëse për menaxhimin e institucionit në lidhje me shlyerjen apo aprovimin e kontributeve dhe përfitimeve, përveç rolit të tij si organ mbikëqyrës apo punëdhënës.

Korporatat publike jo-financiare dhe kuazi-korporatat që janë prodhues të tregut kryesisht të angazhuar në prodhimin e mallrave dhe shërbimeve jo-financiare duhet të klasifikohen si sektorë tjerë. Kjo vlen edhe për prodhuesit publik të përfshirë në aktivitetet e përmendura më lartë dhe që njihen si subjekte të pavarura juridike sipas legjislacionit të veçantë. Nëse përfshihen në listën e IFM, institucionet kreditore të sektorit publik duhet të përfshihen në sektorin tjetër të IFM, e jo nën qeverinë e përgjithshme.

### **Sektorët tjerë**

Kategoria e sektorëve tjerë përfshinë:

- (a) Korporatat tjera financiare janë njësi institucionale që ofrojnë shërbime financiare, ku shumica e aseteve apo detyrimeve të tyre nuk janë në dispozicion në tregjet e hapura financiare. Këto korporata janë të përfshira në nën-sektorin e kompanive të financimit vartëse dhe huadhënësve të parave.
- (b) Korporatat jo-financiare: janë korporatat aktiviteti kryesor i të cilave përfshinë prodhimin e mallrave të tregut apo shërbimeve jo-financiare.
- (c) Ndërmjetësit e tjerë financiar, përveç korporatave të sigurimit dhe fondeve pensionale: korporatat financiare dhe kuazi-korporatat që janë kryesisht të angazhuara në ndërmjetësim financiar duke paraqitur detyrimet në forma tjera përveç përqindjeve të valutave, depozitave apo fondeve investuese; apo në lidhje me skemat e sigurimit, pensionale dhe të garancisë së standardizuar nga njësitë institucionale (përfshinë edhe korporatat e automjeteve financiare të përfshira në transaksionet sekuritizimit, tregtarët e letrave me vlerë dhe derivativëve, korporatat financiare të angazhuara në kreditim dhe korporatat e specializuara financiare);

- a. Ndhmësit financiar: korporatat financiare dhe kuazi korporatat që janë kryesisht të angazhuara në aktivitete të ndërlidhura ngushtë me ndërmjetësimin financiar, por që nuk janë vetë ndërmjetësues financiar;
- b. Kompanitë financiare vartëse dhe huadhënësit e parave: korporatat financiare dhe kuazi-korporatat që nuk janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe as në ofrimin e shërbimeve ndihmëse financiare dhe ku për shumicën e aseteve apo detyrimeve të tyre nuk realizohen transaksione në tregjet e hapura;
- c. Korporatat e sigurimit: korporatat financiare dhe kuazi-korporatat që janë kryesisht të angazhuara në ndërmjetësimin financiar si pasojë e grupimit të rreziqeve, kryesisht në formë të sigurimit apo ri-sigurimit direkt;
- d. Fondet pensionale: të gjitha korporatat financiare dhe kuazi-korporatat që janë kryesisht të angazhuara në ndërmjetësim financiar si pasojë e grupimit të rreziqeve sociale dhe nevojave të personave të siguruar (sigurimi social). Fondet pensionale si skema të sigurimit social ofrojnë të ardhura në pensionim dhe gjithashtu ofrojnë përfitime në rast të vdekjes apo paaftësisë.

(b) Nën-sektorët jo-financiar:

- i. Korporatat jo-financiare (publike, kombëtare - private dhe të huaja): njësitë institucionale që janë subjekte të pavarura juridike dhe prodhues të tregut dhe aktiviteti kryesor i të cilave është prodhimi i mallrave dhe shërbimeve jo-financiare;
- ii. Ekonomitë familjare: individët apo grupet e individëve si konsumatorë dhe si ndërmarrës që prodhojnë mallra të tregut dhe shërbime jo-financiare dhe financiare (prodhues të tregut), me kusht që prodhimi i mallrave dhe shërbimeve nuk bëhet nga subjektet e veçanta të trajtuara si kuazi-korporata. Gjithashtu përfshinë individët apo grupet e individëve si prodhuesit e mallrave dhe shërbimeve jo-financiare për përdorim ekskluziv vetanak përfundimtar;
- iii. Institucionet jo-fitimprurëse që u shërbejnë ekonomive familjare: institucionet jo-fitimprurëse që janë subjekte të veçanta juridike që iu shërbejnë ekonomive familjare dhe që janë prodhues privat jo për treg. Resurset e tyre kryesore janë kontributet vullnetare në para të gatshme apo në natyrë nga ekonomitë familjare në cilësinë e tyre si konsumatorë, nga pagesat e bëra nga qeveria e përgjithshme dhe të ardhurat pronësore.

Transaksionet dhe pozicionet në asetet e jashtme financiare në sektorin institucional të cilit i përket kreditori rezident (pronari i asetit). Transaksionet dhe pozicionet në detyrimet e jashtme financiare i caktohen sektorit institucional të cilit i përket lëshuesi rezident i detyrimit.

Sa i përket rrjedhave dhe stoqeve të tjera të investimit, duhet të shtohet që:

- i. Kreditë e garantuara nga qeveria dhe/ose të siguruar nga banka duhet të trajtohen si operacione private në vend se si kreditim qeveritar apo bankar dhe prandaj duhet të përfshihen tek “sektorët tjerë”. Në këto raste, debitorët kanë krijuar detyrime, por akoma nuk kanë dështuar në pagesën e tyre; detyrimi për kredi të tilla nuk do të mund të transferohej tek qeveria apo banka që i ka garantuar ato deri kur marrësi i kredisë të jetë vonuar në pagesë.

- ii. Kreditë dhe depozitat e lidhura me marrëveshjet e ri-blerjes duhet të klasifikohen nën sektorin institucional të cilit i përket rezidenti që zgjat apo pranon financimin, pavarësisht natyrës së emetuesit të letrave me vlerë që veprojnë si kolateral. Rezidenca e huamarrësit dhe huadhënësit është faktori vendimtar, e jo rezidenca e emetuesit të kolateralit.

#### 4.1.10. Klasifikimi shtesë i aseteve dhe detyrimeve financiare

Sipas BPM6, asetet dhe detyrimet financiare klasifikohen sipas tri kategorive të gjera të instrumenteve: (i) aksionet e fondeve të ekuitetit dhe investimeve, (ii) instrumentet e borxhit, dhe (iii) asetet dhe detyrimet e tjera financiare.

Aksionet e fondeve të ekuitetit dhe investimeve përfshijnë aksionet e listuara dhe jo të listuara, njësitë e tjera të fondeve të ekuitetit dhe investimit si komponentë.

Instrumentet e borxhit përbëjnë një grup të gjerë të instrumenteve financiare, si të drejtat speciale të tirazhit, valutat dhe depozitat (përfshirë ri-blerjet), letrat me vlerë të borxhit (faturat, obligacionet, shënimet, certifikatat e negociueshme të depozitave, dokumentet komerciale, dëftesat e borxhit, letrat me vlerë të mbështetura nga asetet dhe instrumentet e tregut të parasë), kreditë (përfshirë qiratë financiare), rezervat teknike të sigurimit, të drejtat pensionale dhe të ndërlidhura, dispozitat për thirrjet nën garancitë e standardizuara, kreditë tregtare, avancat dhe llogaritë tjera të arkëtueshme/pagueshme.

Asetet dhe detyrimet tjera financiare përfshijnë arin monetar, derivativët financiar dhe opsionet e stokut të punonjësit.

Transaksionet dhe pozicionet në instrumentet e borxhit gjithashtu klasifikohen sipas maturitetit origjinal në plan afatshkurtër (nëse paguhen sipas kërkesës apo me maturitet fillestar prej një viti apo më pak) dhe plan afatgjatë (me maturitet më shumë se një vit apo pa maturitet të theksuar).

## 4.2. MALLRAT

Mallrat janë zëra fizik dhe të prodhuar për të cilët pronësia ndryshon mes rezidentëve dhe jo-rezidentëve. Zëri i mallrave në statistikat e BP të Euro Zonës përfshijnë mallrat e përgjithshme, eksportet neto të mallrave sipas tregtimit dhe arin jo monetar. Në pajtim me parimet e përgjithshme të BP-së, ndërrimi i pronësisë është parim i cili përcakton mbulimin dhe kohën e regjistrimit të transaksioneve ndërkombëtare në mallra.

Tregtimi i përgjithshëm në bazë të bilancit të pagesave (BP) përfshinë mallrat ndërrimi i pronësisë ekonomike të së cilave bëhet mes rezidentit dhe jo-rezidentit dhe që nuk përfshihen në kategori tjera specifike, siç janë mallrat nën tregtim dhe ari jo-monetar, ose si pjesë e disa transaksioneve në shërbime. Eksportet dhe importet e mallrave regjistrohen në bazë FOB (të lira në bord), përkatësisht në vlerën e tregut në kufijtë doganorë të ekonomive eksportuese (përfshirë tarifatat për shërbime sigurimi dhe transporti deri në kufirin e vendit eksportues).

BPM6 rekomandon që alokimi gjeografik për eksportet të bazohet në vendin e destinacionit final ndërsa importet të bazohen në vendin e origjinës.

Tregtimi përkufizohet si blerje e mallrave prej një rezidenti (i ekonomisë statistikore) nga jo-rezidenti, e kombinuar me rishitjen pasuese të mallrave të njëjtë jo-rezidentit tjetër pa i paraqitur mallrat në ekonominë vendase. Eksportet neto të mallrave nën tregtim paraqesin ndryshimin mes shitjeve dhe blerjeve të mallrave me qëllim tregtimi. Ky zë përfshinë marzhat e tregtarëve, fitimet dhe humbjet e tyre si dhe ndryshimet në inventarët e mallrave nën tregtim. Blerja dhe rishitja pasuese e produkteve të naftës së papërpunuar kur bartet transit mes vendit të prodhimit dhe destinacionit të tij final janë shembuj tipikë të tregtimit.

Mallrat e blera nën tregtim tregohen si eksport/kredi negative e ekonomisë së tregtarit. Shitja e mallrave tregohet në kuadër të mallrave të shitur nën tregtim si eksport/kredi pozitive e ekonomisë së tregtarit.

Ari jo-monetar mbulon të gjitha transaksionet ndërkufitare në ar përveç arit monetar. Ari monetar gjendet në pronësi të autoriteteve monetare dhe mbahet si aset rezervë. Ari jo-monetar mund të jetë në formë të shufrave të arit, pluhur ari dhe ari në forma të tjera të papërpunuara ose gjysmë të përpunuara.

Statistikat për tregtinë ndërkombëtare të mallrave janë përpiluar në bazë të të dhënave të marra nga Dogana e Kosovës. Importi dhe eksporti i mallrave vlerësohet me çmime të tregut në kufirin e vendit eksportues për qëllime të BP (FOB) -së. Përmbledhja e mallrave të importuara sipas vendit bazohet në vendin e origjinës së mallrave, ndërsa përmbledhja e mallrave të eksportuara bazohet në vendin final të destinacionit.

Importi i mallrave regjistrohet nga Dogana e Kosovës në bazën CIF. Për të konvertuar importet nga vlerësimi CIF në FOB për qëllime të llogarive ndërkombëtare, duhet të zbritet vlera e transportit dhe primeve të sigurimeve në kufi të vendit eksportues në kufirin e vendit importues. Për mallrat kur pikat doganore të territorit eksportues dhe importues janë afër, vlerat e CIF-it dhe FOB-it do të duhej të ishin të njëjta. Pika e vlerësimit të FOB-it do të thotë që tatimet e eksportit paguhen nga eksportuesi ndërsa taksat doganore të importit dhe tatimet e tjera importuese paguhen nga importuesi. Në rast se kjo nuk ndodh, duhen bërë përshtatje si në tarifa rrugore ashtu edhe në sigurime. Tarifa rrugore për import merret nga Dogana e Kosovës, ndërsa informatat për sigurimin e mallrave të importuara vlerësohet të jetë 1.5% e shumës së përgjithshme të mallrave të importuara. Ky vlerësim bëhet në bazë të anketës së bërë me kompanitë më të mëdha importuese në Kosovë.

### 4.3. SHËRBIMET

Shërbimet janë rezultat i veprimtarisë prodhuese që i ndryshon kushtet e njësive konsumuese, ose lehtëson shkëmbimin e produkteve apo asetëve financiare. Shërbimet në përgjithësi nuk janë zëra të ndarë mbi të cilat mund të vendosen të drejtat e pronësisë dhe zakonisht ato nuk mund të ndahen nga prodhimi i tyre.

Llogaria e shërbimeve në statistikën e BP të Euro Zonës përbëhen nga zërat e mëposhtëm që duhet të regjistrohen në momentin e ofrimit të shërbimeve. Tregtia në shërbime tregon shërbimet e ofruara nga rezidentët për jo-rezidentët dhe anasjelltas. Në kuadër të BP-së, shërbimet nën-kategorizohen si më poshtë:

- Shërbimet e prodhimit për inputet fizike në pronësi të tjerëve;
- Shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimit n.i.e. (të pa-përfshira diku tjetër);

- Transporti;
  - Udhëtimet;
  - Ndërtimet;
  - Shërbimet për sigurime dhe pension;
  - Shërbimet financiare;
  - Tarifatat për përdorimin e pronësisë intelektuale (të pa-përfshira diku tjetër);
  - Shërbimet e telekomunikimit, ato kompjuterike dhe informative;
  - Shërbime tjera afariste;
  - Shërbime personale, kulturore dhe rekreative;
  - Mallrat dhe shërbimet qeveritare (të paspecifikuara dhe të pa-përfshira diku tjetër);
- **Shërbimet e prodhimit për inputet fizike në pronësi të tjerëve:** Shërbimet e prodhimit për inputet fizike të zotëruara nga të tjerët mbulojnë përpunimin, montimin, etiketimin, paketimin e kështu me radhë, të kryera nga ndërmarrjet që nuk zotërojnë mallrat në fjalë. Prodhimi bëhet nga një njësi ekonomike që nuk është në pronësi të mallit dhe tarifa paguhet nga pronari. Në këto raste, pronësia e mallrave nuk ndërron, prandaj nuk regjistrohet kurrfarë transaksion i përgjithshëm i mallrave mes përpunuesit dhe pronarit.

**Shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimit n.i.e. (të pa-përfshira diku tjetër)** përfshijnë riparimin dhe mirëmbajtjen e mallrave nga kompanitë kosovare që janë në pronësi të personave jo-rezidentë dhe anasjelltas. Megjithatë, disa lloje të riparimeve dhe mirëmbajtjes nuk konsiderohen si të tilla, për shembull: mirëmbajtja dhe riparimi i kompjuterëve përfshihen në shërbimet kompjuterike; mirëmbajtja e mjeteve të transportit në porte dhe aeroporte është regjistruar nën shërbimet e transportit.

- **Transporti:** Transporti është procesi i transportimit të njerëzve dhe objekteve nga një vend në tjetrin, si dhe shërbimeve të ndërlidhura mbështetëse dhe ndihmëse. Gjithashtu përfshihen edhe shërbimi postar dhe ai i korrierëve. Transporti mund të klasifikohet sipas:

(a) Llojeve të transportit, përkatësisht detar, ajror ose tjetër ("tjetër" mund të ndahet më tej në transport hekurudhor, rrugor, me rrugë ujore të brendshme, me tubacion dhe transport hapësinor, si dhe transporti për transmisionin e energjisë elektrike;

(b) Asaj çfarë transportohet — udhëtarë apo mallra.

Transporti i udhëtarëve vlerësohet në bazë të të dhënave nga anketat me agjencitë dhe kompanitë ajrore në bazë të të dhënave të SRTN-ë. Vlera e shërbimeve për transportin e mallrave bëhet në bazë të dallimeve mes vlerës së mallrave të importuara në CIF dhe FOB (ana e debitit). Burimet e të dhënave për shpenzimet e mallrave që transportohen janë marrë nga dhënat nga dogana dhe anketat e kompanive. Provizionet dhe tarifatat e agjentëve për shërbimet e ndërlidhura me transport si dhe tarifatat për aterrim në aeroport regjistrohen në anën e kreditit;

- **Udhëtimi:** përfshin shërbimet e ofruara për jo-rezidentët gjatë qëndrimit të tyre në Kosovë (kredi) dhe shërbimet që u ofrohen rezidentëve të Kosovës gjatë qëndrimit jashtë vendit (debit). Shërbimet e ofruara për personelin ushtarak dhe atë diplomatik (p.sh. KFOR-in dhe ambasadat) konsiderohen si shërbime qeveritare. Shërbimet e udhëtimit në BP janë të ndara në dy nënkategori kryesore: udhëtim afarist dhe udhëtim personal.
- Udhëtimet afariste përfshijnë të gjithë llojet e udhëtimit që lidhen me aktivitetet e biznesit, udhëtimet zyrtare të punonjësve qeveritarë, udhëtimet zyrtare të organizatave ndërkombëtare (p.sh. asistenca teknike) dhe punonjësit e kompanive jo-rezidente. Të dhënat për udhëtimin afarist vlerësohen në bazë të informatave nga kompanitë përmes anketimeve dhe të dhënave nga SRTN-ja.
- Udhëtimi personal përfshinë kostot e rezidentëve të Kosovës për udhëtimet jashtë vendit, e të cilët kthehen në Kosovë, dhe që nuk përfshihen në udhëtimin afarist. Këtu përfshihen edhe shpenzimet e akomodimit të personelit ndërkombëtar jo-rezident në Kosovë (kredi) dhe shpenzimet e udhëtimit për stafin rezident ndërkombëtar (debit). Supozohet se stafi ndërkombëtar jo-rezident shpenzon rreth 14% të pagës së tyre në Kosovë. Ky vlerësim bazohet në studimin e Zyrës për politika ekonomike, ish shtylla e 4-të e UNMIK-ut. Burimi kryesor i informatave për përpilimin e anës së debitit për udhëtimin personal është anketa e drejtpërdrejtë me diasporën e bërë nga BQK. Shpenzimet e kosovarëve për pushime jashtë vendit janë bërë duke i kombinuar informatat nga bankat qendrore të rajonit (Banka e Shqipërisë dhe Banka Qendrore e Malit të Zi), si dhe informatat tjera të marra përmes SRTN-së.
- **Ndërtimi:** përfshinë krijimin, rinovimin, riparimin ose zgjerimin e aseteve fikse në formën e ndërtesave, përmirësimet e natyrës inxhinierike të tokës dhe ndërtimet e tjera inxhinierike siç janë rrugët, urat, digat etj. Gjithashtu, përfshin punimet e ndërlidhura me instalimin dhe montimin. Kjo përfshin përgatitjen e lokacionit dhe ndërtimin e përgjithshëm, si dhe shërbimet e specializuara si ngjyrosja, punët hidraulike dhe rrënimet. Gjithashtu përfshin menaxhimin e projekteve të ndërtimit. Blerja e mallrave dhe shërbimeve nga ndërmarrjet që kryejnë punë ndërtimore nga ekonomia në të cilën gjendet lokacioni i punëve ndërtimore gjithashtu regjistrohet në sektorin e ndërtimit. Dy burimet kryesore të të dhënave për shërbimet e ndërtimit janë të dhënat e SRTN-së dhe anketa e ndërmarrjeve. SRTN-ja përdoret për të identifikuar kompanitë e ndërtimit. Të gjitha kompanive kryesore u kërkohet të përfundojnë anketën, të dhënat e të cilës pastaj vërtetohen me të dhënat e SRTN-së nëpërmjet numrit unik të biznesit. Të dhënat për kompanitë, aktiviteti kryesor i të cilave nuk janë shërbime ndërtimore, merren direkt nga SRTN-ja.
- **Shërbimet e sigurimit dhe pensionit:** përfshijnë të gjitha llojet e sigurimeve që kompanitë rezidente të sigurimeve ofrojnë për personat jo-rezident dhe anasjelltas. Shërbimet e sigurimit mund të jenë: sigurimi për mallrat e importuara ose të eksportuara, lloje të tjera të sigurimit të drejtpërdrejtë (p.sh. sigurimi i jetës, sigurimi jo jetë dhe fondet pensionale, sigurimi shëndetësor) dhe ri-sigurimi. Të dhënat për vlerësimin e shërbimeve të sigurimit merren nga të dhënat doganore, raportet mujore nga kompanitë e sigurimeve dhe nga SRTN-ja. Vlerësimi i sigurimit të të mallrave bazohet në vlerën F.O.B të importeve të mallit të transportuar. Raporti i sigurimit të vlerës së mallrave në shumën totale të CIF të importeve konsiderohet të jetë 1.5%.

- **Shërbimet financiare:** përfshijnë shërbimet e ndërmjetësimit financiar dhe shërbimet ndihmëse, përveç shërbimeve të sigurimit dhe fondeve pensionale. Këto shërbime përfshijnë ato që zakonisht ofrohen nga bankat dhe korporatat e tjera financiare. Ato përfshijnë marrjen e depozitave dhe huadhënien, letër kreditë, shërbimet e kredit kartelave, komisionet dhe pagesat që kanë të bëjnë me lizingun financiar, faktorizimin, garantimin dhe shlyerjen e pagesave. Gjithashtu janë përfshirë shërbimet e këshillimit financiar, ruajtja e mjeteve financiare ose shufrat e arit ose argjendit, menaxhimi i aseteve financiare, shërbimet e monitorimit, shërbimet e likuiditetit, shërbimet e riskut përveç shërbimeve të sigurimit, shkrirjes (bashkimit) dhe blerjes, shërbimet e vlerësimit të kredive, shërbimet e bursës dhe shërbimet e mirëbesimit përfshijnë shërbimet e ndërmjetësve dhe ndërmjetësve financiarë, me përjashtim të shërbimeve të sigurimeve dhe fondeve pensionale.

Shërbimet financiare mund të ngarkohen për:

- ✓ Ngarkesave eksplicite (këshillimi financiar, lizingu financiar, menaxhimi i mjeteve, ndërmjetësimi me broker, etj.).
- ✓ Margjinat në transaksionet e blerjes dhe shitjes (kursi i këmbimit, aksionet, obligacionet, shënimet, derivatet financiare dhe instrumentet e tjera financiare shpeshherë blihen dhe shiten në këtë mënyrë).
- ✓ Kostot e menaxhimit të aseteve të zbritura nga të ardhurat e arkëtueshme të pronës në rastin e entiteteve që mbajnë asetet; ose
- ✓ Margjinat midis interesave të pagueshëm dhe normës referuese për huat dhe depozitat (të quajtura Pagesat për Shërbimet e Ndërmjetësimit Financiar të matura në mënyrë indirekte, e cila përdoret si shkurtesë FISIM).

FISIM-i llogaritet kështu:

Për kreditë nga korporatat financiare- dallimi mes interesit të pagueshëm për kreditë dhe shumës që mund të ishte e pagueshme nëse përdoret norma referuese, dhe

Për depozitat me korporatat financiare – dallimi mes interesit që do të fitohej nëse do të përdorej norma referuese dhe interesi i fituar.

Tabela 3. **Llogaritja e FISIM-it**

Të dhënat e nevojshme për llogaritjen e FISIM-it janë:

- (1) vlerat e kredive dhe depozitave (në dispozicion nga PIN);
- (2) interesi përkatës i pagueshëm / i arkëtueshëm (në dispozicion të llogaria e të ardhurave primare); dhe
- (3) norma e zbatueshme referuese (zakonisht është në dispozicion nga buletinet e bankës qendrore dhe publikimet e tjera).

Në këtë shembull, të gjitha kreditë dhe depozitat janë të shprehura në valuta vendore dhe lëshohen nga korporatat financiare. Norma e interesit ndër-bankar është 5 për qind në vit.

Vlera mesatare e huave gjatë vitit = 1000

Interesi aktual i të arkëtueshmeve nga korporatat financiare për hua =

70 i ndarë në:

50 interes i pastër i arkëtueshëm (i nxjerr si 1000 në 5 për qind)

20 FISIM të arkëtueshme (i nxjerr si 70 - 50)

Vlera mesatare e depozitave gjatë vitit = 500

Interesi aktual i pagueshëm nga korporatat financiare për depozita = 10 i ndarë në:

25 interes i pastër i pagueshëm (i nxjerr si 500 në 5 për qind)

15 FISIM të arkëtueshme (i nxjerr si 25 - 10)

Vlera totale e FISIM-it të arkëtueshëm nga korporatat financiare = 35 (20 + 15)

Burimet kryesore të të dhënave për këtë kategori të shërbimeve janë: shërbimet monetare dhe financiare (kreditë, depozitat, normat e interesit) dhe statistikat e BP-së (të ardhurat primare).

▪ **Tarifat për përdorimin e pronësisë intelektuale n.i.e (të pa-përfshira diku tjetër):**

Tarifat për përdorimin e pronësisë intelektuale (të pa-përfshira diku tjetër) përfshijnë:

- ✓ Tarifat për përdorimin e të drejtave pronësore (siç janë patentat, markat tregtare, të drejtat e autorit, proceset industriale dhe dizajnet, duke përfshirë sekretet tregtare, franshizat). Këto të drejta mund të lindin edhe nga kërkimet dhe zhvillimi, si dhe nga marketingu; dhe

- ✓ Tarifat për licencën e riprodhimit ose shpërndarjes (ose të dyja) të pronësisë intelektuale të përfshira në burimet origjinale ose prototipat e prodhuara (siç janë të drejtat e autorit në libra dhe dorëshkrime, softuerë kompjuterik, vepra kinematografike dhe incizime zanore) dhe të drejta të tjera (siç janë performancat e drejtpërdrejta dhe transmetimet televizive, kabllore ose satelitore).

Të dhënat janë përpiluar duke përdorur të dhënat nga SRTN-ja dhe anketat e ndërmarrjeve.

▪ **Shërbimet e telekomunikimit, kompjuterike dhe informative:**

- ✓ Shërbimet e telekomunikimit përfshijnë transmetimin e zërit, pamjeve, të dhënave ose informatave të tjera me anë të telefonit, teleksit, telegramit, transmetimit kabllor radioteleviziv, sateliteve radiotelevizive, postës elektronike, faksimilit e kështu me radhë, duke përfshirë shërbimet e rrjeteve afariste, telekonferencat, dhe shërbimet mbështetëse.
- ✓ Shërbimet kompjuterike përfshijnë provizionet e paguara ose të marra nga personat jo-rezident në shërbimet siç janë: zhvillimi i bazës së të dhënave, ruajtjen e të dhënave, shërbimet 'on-line', seritë kohore, përpunimin e të dhënave, vendosjen (input) e të dhënave; dizajnimin, zhvillimin, zbatimin, programimin e softuerëve; këshillimin për pjesët elektronike; riparimin dhe mirëmbajtjen e harduerëve/pjesëve periferike të kompjuterëve si dhe shërbime tjera të ndërlidhura.
- ✓ Shërbimet informatike përfshijnë pagesat që kanë të bëjnë me shërbimet e marra nga agjencitë e lajmeve, sigurimi dhe shpërndarja e informatave etj.

Burimet kryesore e të dhënave për këtë kategori shërbimesh janë: anketat me ndërmarrjet e telekomunikacionit, stacionet televizive dhe ndërmarrjet tjera të ngjashme si dhe SRTN-ja.

**Shërbimet tjera afariste:** përfshijnë shërbime të ndryshme afariste siç janë: shërbimet hulumtuese dhe zhvillimore, shërbimet e konsulencës profesionale dhe menaxhimit, shërbimet teknike, tregtare dhe shërbimet e tjera afariste, trajtimin të mbeturinave dhe kundër-ndotjes, shërbime bujqësore dhe minerare, lizing operativ, shërbimet e ndërlidhura me tregtinë dhe shërbime të tjera afariste.

- **Shërbimet personale, kulturore dhe rekreative:** këto shërbime përbëhen nga: (a) shërbimet audio-vizuale dhe të ngjashme dhe (b) shërbimet e tjera personale, kulturore dhe rekreative. Shërbimet audio-vizuale dhe të ngjashme përbëhen nga shërbimet dhe tarifat që ndërlidhen me prodhimin e filmave (në film, shirit, disk ose transmetohet në mënyrë elektronike, etj.), programet radiotelevizive (drejtpërdrejt ose në shirit) si dhe regjistrimet muzikore. Shërbime tjera personale, kulturore dhe rekreative përfshijnë shërbimet shëndetësore, arsimore dhe shërbime tjera. Shërbimet tjera personale, kulturore dhe rekreative përfshijnë ato shërbime që ndërlidhen me muzetë dhe aktivitete tjera kulturore, sportive, lojërave të fatit dhe atyre rekreative, përveç atyre që përfshihen në udhëtime. Këtu përfshihen tarifat dhe shpërblimet për atletë.
- **Mallrat dhe shërbimet qeveritare n.i.e (të pa-përfshira diku tjetër):** përfshijnë të gjitha transaksionet me ambasadat, konsullatat, organizatat ndërkombëtare, njësitë ushtarake dhe agjencitë e mbrojtjes me staf rezident ose personel ushtarak në ekonomitë në të cilat janë vendosur.

Të gjitha transaksionet me ambasadat e huaja dhe eksporti i mallrave dhe shërbimeve me KFOR-in regjistrohen si kredi në BP. Burimet kryesore e të dhënave për këtë kategori shërbimesh janë: SRTN-ja, ambasadat, qeveritë dhe agjencitë qeveritare, UNMIK-u dhe EULEX-i.

Mallrat dhe shërbimet qeveritare n.i.e (të pa-përfshira diku tjetër) mbulojnë këto kategori:

- ✓ mallrat dhe shërbimet e ofruara nga dhe në enklava si ambasadat, bazat ushtarake dhe organizatat ndërkombëtare;
- ✓ mallrat dhe shërbimet e mara në ekonominë pritëse nga diplomatët, stafi konsullor dhe personeli ushtarak i vendosur jashtë vendit dhe vartësit e tyre; dhe
- ✓ Shërbimet e ofruara nga dhe për qeveritë e që nuk përfshihen në kategoritë e tjera të shërbimeve.

## 4.6. TË ARDHURAT PRIMARE

Komponenti i të ardhurave primare ndërlidhet me të ardhurat e fituara nga tre faktorët e prodhimit: puna, ekuitetit dhe toka. Rrjedhimisht, të ardhurat përbëhen nga kompensimi i punonjësve që punojnë jashtë vendit dhe të ardhurat nga investimet.

### 4.4.1 Kompensimi i punonjësve

Kompensimi i të punësuarve përfshin pagat, mëditjet, shtesat dhe përfitimet e tjera që paguhen nga ndërmarrjet rezidente për punonjësit jo-rezidentë ose që fitohen nga rezidentët e punësuar jashtë vendit për punën e kryer dhe që paguhen nga personat rezident të atyre ekonomive. Kjo përfshin punëtorët sezonal ose punëtorët e tjerë afatshkurtër (më pak se një vit) dhe punëtorët kufitar të cilët janë rezident të një ekonomie dhe punojnë në një ekonomi tjetër.

Kompensimi i punonjësve i paguar nga organizatat ndërkombëtare dhe KFOR-i për punëdhënësit rezident regjistrohen në anën e kredisë së kompensimit të punonjësve (me përjashtim të kompensimit të fituar nga punonjësit rezident që punojnë për UNMIK-un dhe EULEX-in, të cilët regjistrohen në kuadër të transfereve rrjedhëse). Kompensimi i punonjësve kalkulohet në bazë të burimeve të ndryshme të informatave, përfshirë të dhënat e mbledhura drejtpërdrejt nga UNIMK-u, EULEX-i, KFOR-i, Ministrinë, Ambasadat dhe organizatat e tjera ndërkombëtare. Prandaj, të dhënat e kompensimit të punonjësve regjistrohen si paga bruto duke përfshirë kontributet dhe taksat.

### 4.4.2 Të ardhurat nga investimet

Të ardhurat nga investimet rrjedhin si rezultat i posedimit nga rezidenti i një aseti financiar që lëshohet nga një jo-rezident (kredit), apo e kundërta, si rezultat i posedimit nga jo-rezidenti i një aseti financiar të lëshuar nga rezidenti (debit). Të ardhurat nga investimet përfshijnë të ardhurat nga ekuiteti (dividendët, tërheqjet nga të ardhurat e kuazi-korporatave, fitimet e riinvestuara dhe të

ardhurat nga investimet që i atribuohen aksionarëve të fondit të investimeve) dhe borxhi (interesi), si dhe të ardhurat nga investimet që i atribuohen mbajtësve të polisave të sigurimeve, skemave pensionale dhe skemave të standardizuara të garancisë. Fitimet dhe humbjet nga ekuiteti (të realizuara ose të përealizuara) nuk klasifikohen si të hyra për investime, por si rivlerësime (për shkak të kursit të këmbimit ose ndryshimeve të tjera të çmimeve).

#### 4.4.2.1 Të ardhurat nga investimet direkte

Të ardhurat nga investimet direkte përfshijnë të gjitha të ardhurat nga investimet që rrjedhin nga ekuiteti i investuar direkt dhe huadhëniet ndër-bankare midis njësive institucionale rezidente dhe jo rezidente.

Ana a e kredisë së investimeve direkte përfaqëson të ardhurat e fituara nga investimet direkte jashtë vendit. Përderisa pala debitore përfaqëson të ardhurat e fituara nga investitorët e direkt jo-rezidentë në Kosovë. Të dhënat paraqiten veçmas për të ardhurat nga ekuiteti dhe të ardhurat nga borxhi. Të ardhurat nga ekuiteti ndahen në "dividentë dhe filiale të shpërndarjes së fitimit" dhe "fitimet e riinvestuara dhe fitimet e jo të shpërndara të filialeve".

Burimet kryesore të të dhënave mbi të ardhurat nga investimet direkte janë vrojtimitet tremujore të ndërmarrjeve dhe të dhënat nga Sistemi i Raportimit të Transaksioneve Ndërkombëtare (SRTN).

#### 4.4.2.2 Të ardhurat nga investimet e portofolit

Të ardhurat nga investimet e portofolit përfshijnë flukset e të ardhurave midis rezidentëve dhe jo rezidentëve që rrjedhin nga pozicionet në ekuitet (dividendët) dhe letrat me vlerë të borxhit (fletë-obligacionet, dëftesat dhe instrumente të tregut të parasë), përveç atyre të klasifikuara në investime direkte apo mjete rezervë, siç përcaktohet në BPM6.

Deri më tani nuk ka pasur të ardhura nga investimet e portofolit jashtë vendit që janë regjistruar në formën e kapitalit. Ndërsa burimi i të dhënave mbi të ardhurat nga investimet në letra me vlerë të borxhit janë BQK-ja, bankat komerciale, kompanitë e sigurimeve, fondet pensionale dhe SRTN.

#### 4.4.2.3 Të ardhura nga investime tjera

Të ardhurat e tjera nga investimet mbulojnë flukset ndërmjet njësive institucionale rezidente dhe jo rezidente në lidhje me interesin për depozitat, huadhëniet, kreditë tregtare dhe paradhëniet, si dhe llogaritë e tjera të arkëtueshme/pagueshme; të ardhurat mbi ekuitetin dhe aksionet e fondeve të investimit të cilat nuk klasifikohen në asnjë kategori tjetër funksionale; dhe të ardhurat nga investimet që i atribuohen mbajtësve të policave në sigurime, garancitë e standardizuara dhe fondet pensionale. Interesat e pagueshme për alokimet e DST-së regjistrohen nën të ardhurat e tjera të investimit.

Të ardhurat nga huadhëniet, depozitat dhe asetet rezervë regjistrohen në baza rrjedhëse. Huadhëniet llogariten bazuar në anketat e ndërmarrjeve dhe SRTN.

#### 4.4.3 Të ardhurat nga asetet rezervë

Të ardhurat e investimeve të aseteve rezervë përfshijnë të ardhurat nga kapitali dhe aksionet e fondeve të investimit, si dhe interesat. Tarifat për kreditimin e sigurisë dhe huadhëniet e arit monetarë dhe interesat për llogaritë e arit të jo të alokuar përfshihen gjithashtu në interesin e aseteve rezervë. Të ardhurat nga kapitali dhe aksionet e fondeve të investimeve mund të klasifikohen më tutje në dividendët në letrat me vlerë të kapitalit dhe të ardhurat që i atribuohen aksionarëve të fondit të investimit. Kjo e fundit përfshin si fitimet e shpërndara ashtu dhe ato të riinvestuara. Interesat e arkëtueshme mund të klasifikohen sipas llojit të instrumenteve financiare. Burimet e të dhënave për të ardhurat në asetet rezervë janë statistikave monetare dhe financiare.

#### 4.5 TË ARDHURAT DYTËSORE

Kjo kategori përbëhet nga transaksione të njëanshme që Kosova merr nga një vend tjetër pa ofruar asnjë burim real ose zë financiar në këmbim të këtij transaksioni. Transaksionet mund të jenë në formën e burimeve reale, të tilla si mallrat apo shërbimet, apo një zë financiar. Transferet klasifikohen veçmas si transfere rrjedhëse dhe kapitale. Transferet rrjedhëse regjistrohen nën llogarinë rrjedhëse të bilancit të pagesave, ndërsa transaksionet kapitale regjistrohen nën llogarinë kapitale.


Ndarja e transferit në këto dy kategori është i domosdoshëm për harmonizim të bilancit të pagesave me llogaritë kombëtare. Transferet rrjedhëse ndikojnë drejtpërsëdrejti në nivelin e të ardhurave të disponueshme dhe duhet të ndikojnë në konsumin e mallrave apo shërbimeve. Transferet kapitale janë transferimi i pronësisë së aseteve fikse dhe falja e borxheve. Të ardhurat dytësore përfaqësojnë rishpërndarjen e të ardhurave nëpërmjet transfereve rrjedhëse, të tilla si transferet qeveritare dhe transfere të tjera (bamireshë ose remitanca etj.)

- **Spektori qeveritar:** përbëhet nga ndihma shtetërore nga jashtë vendit. Prandaj, transferet rrjedhëse të sektorit qeveritar janë ndihma në formë të asistencës teknike (grante, donatorë dhe kosto direkte të EULEX-it). Burimet kryesore të të dhënave për vlerësimin e transfereve rrjedhës në sektorin qeveritar në Kosovë janë Agjencia për Koordinimin e Zhvillimit dhe Integritet Evropian (Ministria e Integritet Evropian), institucionet e tjera qeveritare, BE-ja dhe raporti SRTN.
- **Korporatat financiare dhe jo-financiare, ekonomitë financiare dhe OJSHEF-ja:** përmban transaksione të tilla si transferet personale (përfshirë remitancat), transferet e tjera rrjedhëse (kontributet sociale dhe përfitimet, tatimet e tjera mbi të ardhurat dhe pasurinë). Meqenëse remitancat janë një element kryesor në transferet personale, vëmendje e veçantë i është kushtuar metodës së hartimit të statistikave të remitancave.

Remitancat e punëtorëve përfshijnë transferet rrjedhëse nga emigrantët të cilët janë të punësuar jashtë vendit dhe konsiderohen si rezident në ekonominë në të cilën punojnë. Migranti është personi i cili vjen në një ekonomi dhe qëndron për një vit apo më tepër. Personat të cilët qëndrojnë në ekonomi të reja për më pak se një vit, konsiderohen jo-rezident; transaksionet e tyre janë të përshtatshme kryesisht për komponentin e kompensimit të punonjësve.

Vlerësimi i të hyrave nga remitancat është bërë duke u bazuar në kanalet kyçe të rrjedhjes së tyre. Një varietet i burimeve të të dhënave është përdorur për matjen e fluksit hyrës të remitancave. Fokus i veçantë i është dhënë identifikimit të remitancave nga kanalet institucionale (bankat, agjencitë për transferin e mjeteve, dhe paratë e deklaruara pikat kufitare) dhe remitancat që vijnë përmes kanaleve jo institucionale (paraja e gatshme e padekluar në pikat kufitare, dhe remitancat në mallra nga emigrantët që jetojnë jashtë Kosovës. Skema e përpilimit të remitancave që hyjnë në Kosovë (anën e kredisë) është paraqitur më poshtë:

**Figura 2. Kanalet e remitancave**



Në anën e debitit të bilancit të pagesave, remitancat përfshijnë dërgesat e stafit ndërkombëtar rezidentë në Kosovë. Vlerësohet se stafi ndërkombëtar dërgojnë si remitanca rreth 76% të pagës së tyre tek familjarët e tyre jashtë vendit. Burimet e të dhënave për punëtorët e huaj rezidentë të Kosovës janë buxheti i UNMIK/EULEX dhe Agjencia për Koordinimin e Zhvillimit dhe Integrimin Evropian (Zyra e Kryeministrit).

Burimet kryesore të të dhënave për vlerësimin e transfereve të sektorëve jo qeveritarë janë raporti i SRTN-së, të dhënat e tjera nga bankat, dogana e Kosovës, Anketa mbi Buxhetin Familjar (e zbatuar nga AKS-ja) si dhe nga burime të tjera.

#### 4.6. LLOGARIA KAPITALE

Llogaria kapitale mbulon blerjen/posedimin e aseteve të pa-prodhuara, jo-financiare dhe transfereve kapitale. Shuma e bilanceve të llogaris rrjedhëse dhe kapitale mund të tregohet edhe si element i bilancit, i cili etiketohet si huadhënie neto (+) / huamarrje neto (-).

##### 4.6.1. Blerja dhe posedimi i aseteve të pa-prodhuara, jo-financiare

Asetet e pa-prodhuara, jo-financiare përbëhen nga: (i) burimet natyrore (toka, të drejtat minerare, të drejtat e pylltarisë, uji, të drejtat e peshkimit, hapësira ajrore dhe spektri elektromagnetik); (ii)

kontratat, qiratë dhe patentat; dhe (iii) aktivet e marketingut (emrat e brendeve, markave tregtare) dhe vullneti i mirë.

Burimet kryesore të të dhënave për vlerësimin e transfereve kapitale janë raporti i SRTN, të dhënat nga KFOR-i, si dhe vlerësime nga burime të tjera të ndryshme të identifikuar nga DP i BQK-së.

#### 4.6.2. Transferet kapitale

Transferet kapitale përbëhen nga: (i) transferimi i pronësisë së aseteve fikse; (ii) transferet e fondeve të lidhura ose të kushtëzuara me blerjen ose posedimin e aseteve fikse; dhe (iii) anulimin të detyrimeve nga kreditorët (si falja e borxhit), pa pranimin të çfarëdo konsiderate si kthim.

Mbledhja e të dhënave për përpilimin e llogarisë kapitale është pjesë e sistemit të përgjithshëm të raportimit. Brenda kësaj kategorie regjistrohen të gjitha transaksionet e pranimeve ose pagesave të: (1) transfereve kapitale dhe (2) transaksioneve në asetet e pa-prodhuara, jo-financiare (si patentat dhe të drejtat e autorit). Burimi i të dhënave janë kryesisht Ministria e Financave dhe SRTN-ja.

Transferet kapitale shoqërohen me transferimin e pronësisë së një asemi fiks, ose faljen e një detyrimi nga një kreditor në mënyrë të njëanshme pa shpërblim. Falja e borxhit është e definuar si fshirje vullnetare e borxhit në mes të një kreditori dhe një debitori nga një vend tjetër. Burimet e të dhënave janë të dhënat e marra nga institucionet qeveritare, SRTN dhe të dhëna të tjera administrative.

### 4.7. LLOGARIA FINANCIARE

Llogaria financiare mbulon transaksionet në asetet e jashtme financiare (kërkesat ndaj jo rezidentëve) dhe detyrimet e huaja financiare (detyrimet ndaj jo rezidentëve). Të katër kategoritë (investimet direkte, investimet portfolio, investimet tjera dhe asetet rezerve), bazohen kryesisht në marrëdhënien mes palëve, dhe së dyti mbi natyrën e instrumentit të përfshirë

#### 4.7.1. INVESTIMET DIREKTE

Flukset e investimeve direkte regjistrohen në bazë të pasurisë/detyrimeve:

- **Investime direkte në vend:** Investimi direkt në Kosovë përfshinë investimet neto nga kompanitë e huaja në filialet e tyre të vendosura në Kosovë. BQK-ja përdor burime të ndryshme të informatave për kalkulimin e IHD-ve. Burimi kyç i informacionit për vlerësimin e IHD-ve në Kosovë është Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), raportet e bankave komerciale për BQK-në (SRTN) dhe Anketat e ndërmarrjeve.
- **Investimi direkt jashtë vendit:** mbulon investimet neto nga ndërmarrjet amë rezidente të Kosovës, në filialet e huaja, nëndegët dhe kompanitë e lidhura.

##### 4.7.1.1. Përkufizimi i IHD-ve

Investimi direkt është kategori e investimeve ndërkufitare të shoqëruara me një rezident në një ekonomi që ka kontroll ose një shkallë të konsiderueshme të ndikimit në menaxhimin e një ndërmarrjeje që është rezidente në një ekonomi tjetër. Në përpilimin e statistikave të BP, BQK-ja përdor kriteret e paraqitura si më poshtë:

- Ekziston kontrolli nëse investitori direkt zotëron më shumë se 50 për qind të fuqisë së votimit në investimin direkt të kompanisë, dhe
- Ekziston një shkallë e konsiderueshme ndikimi nëse investitori direkt zotëron 10-50 përqind të fuqisë votuese në ndërmarrjen e investimeve direkte.

Duke përdorur këto kritere, mund të ekzistojë një marrëdhënie e investimeve direkte mes një numër ndërmarrjesh, pavarësisht nëse vargu i tyre lidhës përfshin një zinxhir të vetëm ose një numër zinxhirësh. Komponentët e transaksioneve të investimeve direkte janë:

- Kapitali aksionar: përfshinë investimet në kompanitë e përfshira ëmë – bijë, aksionet në nëndegë dhe ortakëri (përveç aksioneve të preferuara jo pjesëmarrëse që trajtohen si letra me vlerë të borxhit), dhe kontributet e tjera të kapitalit;
- Fitimi i ri-investuar - përbëhet nga të hyrat e kompensuara për llogarinë rrjedhëse korresponduese të mjetit të hyrave: është pjesa e investitorit direkt të fitimit të pashpërndarë të degëve të tyre, nëndegëve dhe ortakëve;

Instrumentet e borxhit: mbulojnë të gjitha transaksionet financiare mes degëve (huamarrjes dhe huadhënies së fondeve), duke përfshirë letrat me vlerë të borxhit dhe kreditë tregtare.

Për shkak të natyrës komplekse të vlerësimeve fillestare të investimeve direkte ato rishikohen shpesh kur llogaritë vjetore bëhen të disponueshme. Në raste të tilla, do të kontaktohen kompanitë për të verifikuar informacionin. Gjithashtu, mund të lindin disa mangësi në lidhje me identifikimin e kompanive të marrëdhënies indirekte.

#### 4.7.1.2. Metodatat vlerësuese

Fitimet e riinvestuara rrjedhin si fitimi neto nga periudha raportuese pas zbritjes së shumës së dividendëve të paguar ndaj aksionarëve. Megjithatë, shuma aktuale e dividendit që duhet paguar nuk është në dispozicion deri në fund të vitit, kur merret vendimi për shpërndarjen e dividendëve. Vlerësimi i të ardhurave neto të riinvestuara përfshihet si e dhënë paraprake për BP dhe zëvendësohet me të dhënat më të fundit kur shuma aktuale e dividendëve të paguaeshëm është në dispozicion.

### 4.7.2. INVESTIMET E PORTFOLIOS

Portofoliot e investimeve janë pjesë e sistemit të përgjithshëm të raportimit. Letrat me vlerë të borxhit përfshijnë fletë-obligacionet dhe dëftesat, që përmbajnë afat të kohëzgjatjes më shumë se një vit dhe instrumentet e tregut të parasë me kohëzgjatje prej një viti apo më pak. Të dhënat mbi letrat me vlerë të borxhit, në rastin e Kosovës, përfshijnë investimet në letrat me vlerë jashtë BQK-ja dhe bankat komerciale. Grumbullimi i këtyre statistikave bëhet rregullisht në baza tremujore.

Burimi kryesor i informatave mbi portofolin e investimeve janë të dhëna të siguruara nga BQK dhe bankave komerciale që operojnë në Kosovë dhe fondet pensionale.

#### 4.7.2.1. PËRKUFIZIMI

Kjo kategori mbulon blerjen dhe posedimin e ekuitetit dhe letrave me vlerë të borxhit, të cilat nuk mund të klasifikohen në kuadër të transaksioneve të investimeve direkte apo të aseteve rezerve.

Letrat me vlerë të përfshira tregtohen (apo janë të tregëtueshme) në tregjet e organizuara dhe tregjet e tjera financiare.

### 4.7.3. INVESTIME TJERA

Investimet e tjera janë pjesë e sistemit të përgjithshëm të raportimit. Informatat lidhur me kapitalet, valutën dhe depozitat, huadhëniet dhe rezervat teknike të garancive janë siguruar nga bilanci gjendjes së bankave komerciale, bilanci i gjendjes i BQK-së, MEF-it (depozitat qeveritare jashtë vendit), bilanci i gjendjes i institucioneve tjera financiare, SRTN-ja (depozitat dhe huadhëniet e entiteteve jo-financiare me jashtë) dhe anketat e ndërmarrjeve (llogari tjera të pagueshme/arkëtueshme).

#### 4.7.3.1. PËRKUFIZIMI

Investimet tjera mbulojnë asetet dhe detyrimet tjera përveç atyre të klasifikuara si investime direkte, investime të portofolio apo mjetet rezervë. Investimet tjera, përfshijnë ekuitetin tjetër, huadhëniet afatshkurta dhe afatgjata, valutën dhe depozitat, kreditë tregtare dhe paradhëniet, garancionet teknike rezervë. Kreditë tregtare afatshkurta përfshijnë para-pagesat nga jo-rezidentët për eksportet e ardhshme (në anën e detyrimeve) dhe pagesat e pritura të vonuara për eksport nga ana e jo-rezidentëve (në anën e pasurive). Këto të dhëna janë të disponueshme në baza mujore.

#### 4.7.3.2. METODAT E VLERËSIMIT

Vlerësimi i kredive tregtare bëhet duke marrë parasysh të dhënat e marra nga doganat dhe SRTN-ja dhe duke përdorur vlerësimet ditore.

Vlerësimi i parasë në qarkullim bazohet në kombinimin e të dhënave të siguruar nga vlerësimet e Departamentit të Statistikave të ASK-së dhe BQK-së.

### 4.7.4. ASETET REZERVË

Mbledhja e të dhënave mbi asetet rezervë është pjesë e sistemit të përgjithshëm të raportimit. Burimi i të dhënave është Divizioni i Statistikave Monetare dhe Financiare të BQK-së. Mjetet rezervë janë në dispozicion në baza mujore.

#### 4.7.4.1. PËRKUFIZIMI

Asetet rezervë përbëhen nga asetet e jashtme të cilat kontrollohen nga autoritetet monetare dhe janë të gatshme për financim direkt të imbalancave të pagesave ndërkombëtare, për rregullimin indirekt të madhësisë së deficitit të tillë përmes intervenimit në tregjet e këmbimit valutor për të influencuar normën e këmbimit valutor dhe/ose për qëllime të tjera. Asetet rezervë përbëhen nga:

Ari monetar,

Të Drejtat Speciale të Tirazhit (DST)

Pozicioni i rezervave në FMN,

Valuta e jashtme,

Kërkesat tjera.

Në rastin e Kosovës, asetet rezervë përbëhen nga DST-të, pozicioni i rezervave në FMN, dhe nga kërkesat ndaj jo-rezidentëve (në valutën euro). Prandaj, asetet rezervë përbëhen nga kërkesat e BQK-së ndaj jo-rezidentëve në formë të parasë së gatshme në BQK, depozitave të BQK-së të investuara jashtë Kosovës, si dhe letrave me vlerë. Kjo përbënë konceptin bruto të rezervave ndërkombëtare. Më pastaj kësaj shume i zbritet vlera e depozitave të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe vlera e Fondeve Pensionale në BQK, sepse këto depozita të mbajtura në BQK nuk përputhen me tiparin esencial të 'kontrollit' të rezervave ndërkombëtare.

#### **4.7.5. GABIMET DHE LËSHIMET NETO**

Teorikisht, shuma e të hyrave në anën e kredisë, duhet të barazojë shumën e të hyrave në anën e debitit përgjatë periudhës së referuar. Në praktikë, meqë disa transaksione mund të mos përfshihen apo për shkak të diferencës në mbulueshmëri, vlerësimi dhe koha e transaksioneve, nuk paraqet simetri ekzakte dhe zëri balancues i gabimeve dhe lëshimeve neto shfaqen për të balancuar llogarinë e përgjithshme. Madhësia e këtij zëri duhet të jetë relativisht e vogël në raport me vlerën e kombinuar të të gjitha transaksioneve në kredi dhe debi të shprehura në terma absolut.

